



302 MILIONË USD NGA SHBA PËR MODERNIZIMIN E MBROJTJES SHQIPTARE

» faqe 3



NËNSHKRUHET AKTI I THEMELIT TË "FINCANTIERI ALBANIA", INVESTIM STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E KANTIERIT TË PASHALIMANIT

Në Gjenova të Italisë, në Divizionin e Anijeve Detare të kompanisë prestigjioze italiane FINCANTIERI, është hedhur një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit strategjik mes Shqipërisë dhe Italisë në fushën e industrisë detare dhe mbrojtjes. Gjatë ceremonisë së zhvilluar në ambientet e kompanisë FINCANTIERI, u nënshkruan Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë "Fincantieri Albania"...

faqe 3



"MADE IN ALBANIA" PËR MBROJTJEN KOMBËTARE. FILLIMI I NJË EPOKE TË RE PËR FORCAT E ARMATOSURA

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga importues të pajisjeve ushtarake drejt ndërtimit të një industrie kombëtare të mbrojtjes. Ky është mesazhi kryesor që përcjell dorëzimi i 40 mjeteve të para taktike të prodhuara në Shqipëri, sipas standardeve të NATO-s. Për shumë vite, modernizimi...

faqe 5



NUK IKIN POETËT... ATA THJESHT IA DORËZOJNË FJALËN PËRJETËSISË

Arben Duka, skënderbegasi që e ktheu penën në mision dhe fjalën në atdhe. "Njeriu jeton aq sa jeton emri i tij në kujtesën e njerëzve. Poeti jeton edhe më gjatë, sepse ai banon në zemrat e atyre që nuk i ka njohur kurrë". Ka njerëz që e shkruajnë historinë me vendime. Të tjerë e mbrojnë atë me armë. Ka edhe nga ata të rrallët që e ruajnë me fjalë. Në një komb të vogël si yni, ku kujtesa shpesh vihet në provë dhe koha tenton të zbehë edhe figurat më të ndritura...

faqe 8

KAMPIONËT NË SHËRBBIM TË UNIFORMMËS

Sporti bëhet pjesë e formimit të oficerëve të së nesërme

Ministri i Mbrojtjes prezanton nismën për krijimin e klasave sportive në Akademinë e Forcave të Armatosura

Sportistët elitare do të kontribuojnë në formimin e brezit të ri të ushtarakëve

Përvoja, disiplina dhe fryma e garës që kanë karakterizuar sportistët elitare shqiptarë do të vihen në shërbim të formimit të brezit të ri të ushtarakëve. Kjo ishte në qendër të takimit që ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, zhvilloi me sportistët elitare, pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ku u prezantua nisma për përfshirjen e tyre në organizimin e klasave sportive si program ekstrakurrikular në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe në strukturat e FA-së.

Në takim ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**, ndërsa diskutimet u përqendruan në rëndësinë që do të ketë angazhimi i kampionëve dhe sportistëve elitare në përgatitjen fizike, psikologjike dhe profesionale të kadetëve dhe personelit ushtarak.

Ministri Nufi vlerësoi kontributin e sportistëve, jo vetëm për sukseset e arritura në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, por edhe për rolin e tyre si pjesëtarë të Forcave të Armatosura.

“Përvoja e sportistëve elitare do të kontribuojë në përmirësimin e metodave të stërvitjes, forcimin e disiplinës, frymës së garës dhe përgatitjes për përballimin e sfidave operacionale, emergjencave civile dhe misioneve ndërkombëtare”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai theksoi se modeli i suksesit, përkushtimit dhe profesionalizmit të këtyre sportistëve përbën një frymëzim të çmuar për brezat e rinj të ushtarakëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e standardeve të përgatitjes dhe të lidërshiptit në Forcat e Armatosura. Nisma parashikon krijimin e klasave sportive në Akademinë e Forcave të Armatosura, me synim zhvillimin fizik dhe psikologjik të kadetëve, përmirësimin e performancës sportive të personelit ushtarak, promovimin e kulturës sportive në radhët e Forcave të Armatosura, si edhe ngritjen e ekipeve përfaqësuese për pjesëmarrje në aktivitete dhe gara sportive brenda dhe jashtë vendit.

Në kuadër të këtij programi, sportistët elitare do të angazhohen në mënyrë vullnetare si pedagogë të jashtëm, trajnerë, mentorë, lektorë motivues dhe konsulentë teknikë. Programi do të zbatohet në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe federatat sportive.

Klasat sportive do të përfshijnë një gamë të gjerë disiplinash, ndër to xhudo, mundje, boks, taekwondo, karate,



kickboxing, biathlon dhe pentathlon ushtarak, qitje, atletikë, peshëngritje, gjimnastikë dhe sporte ekipore, duke shfrytëzuar infrastrukturën moderne sportive të Akademisë së Forcave të Armatosura. Me këtë nismë, Ministria e Mbrojtjes synon të ndërthurë përvojën e kampionëve me përgatitjen ushtarake,

duke krijuar një model bashkëkohor edukimi dhe stërvitjeje, ku sporti shërben si një instrument i rëndësishëm për zhvillimin e aftësive fizike, forcimin e karakterit, disiplinës dhe frymës së ekipit – vlera thelbësore për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Forcat e Armatosura, në vijën e parë të përballimit të zjarreve

Gjenerallejtënant Arben Kingji vlerëson angazhimin dhe profesionalizmin e efektivëve ushtarakë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, ka shprehur mirënjohjen e tij të veçantë për efektivët e FA-së, të cilët vijnë në jenë të angazhuar në operacionet për përballimin dhe shuarjen e vatrave të zjarrit në zona të ndryshme të vendit. Në një mesazh vlerësimi për trupat pjesëmarrëse në këto operacione, gjenerallejtënant Kingji theksoi gatishmërinë e lartë, përkushtimin dhe profesionalizmin e ushtarakëve, të cilët janë rreshtuar në ndihmë të komuniteteve dhe në mbrojtje të pasurive natyrore e të jetës së qytetarëve.

“Mirënjohje e veçantë për efektivët e Forcave të Armatosura për angazhimin dhe gatishmërinë e tyre maksimale në operacionet për shuarjen e zjarreve. Përkushtimi dhe profesionalizmi juaj janë dëshmi e misionit fisnik që kryeni në shërbim të qytetarëve dhe vendit”, - u shpreh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Forcat e Armatosura, në koordinim me strukturat e tjera të emergjencave civile, vijnë të kontribuojnë me personel dhe kapacitete operacionale për menaxhimin e situatave të krijuara nga zjarret, duke dëshmuar edhe një herë rolin e tyre të rëndësishëm në mbështetje të shoqërisë.

Angazhimi i efektivëve ushtarakë në këto operacione është një tjetër dëshmi e përmbushjes së misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, jo vetëm në garantimin e sigurisë kombëtare, por edhe në mbrojtjen e jetës, komuniteteve dhe mjedisit në raste emergjencash.



SHBA-të zyrtarizojnë marrëveshjen historike të financimit ushtarak, një investim strategjik për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe sigurinë e Aleancës

Një tjetër moment me rëndësi historike për marrëdhëniet strategjike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës është shënuar me ratifikimin zyrtar nga Departamenti i Shtetit Amerikan të marrëveshjes së huas në vlerën **302 milionë dollarë**, në kuadër të programit **Foreign Military Financing (FMF)**. Financimi përfaqëson një nga investimet më të rëndësishme të realizuara ndonjëherë për modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe konfirmon nivelin e lartë të besimit strategjik që SHBA vijon t'i japë vendit tonë.

Sipas autoriteteve amerikane, ky financim do të shërbejë për modernizimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura shqiptare, përmes blerjes së sistemeve dhe pajisjeve kryesore me origjinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke rritur njëkohësisht aftësitë mbrojtëse të Shqipërisë dhe kontributin e saj në sigurinë euroatlantike.

Në deklaratën zyrtare të Departamentit të Shtetit vihet në dukje gjithashtu se Shqipëria mbetet një aleate e besueshme e NATO-s dhe një partnere e ngushtë e Shteteve të Bashkuara në çështjet më të rëndësishme të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Lidhur me këtë zhvillim ka reaguar edhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nuçi, i cili e cilësoi ratifikimin e marrëveshjes si një moment historik për mbrojtjen shqiptare dhe një dëshmi të partneritetit të palëkundur me SHBA-në.

“Ky është një votëbesim strategjik i Shteteve të Bashkuara ndaj Shqipërisë dhe një hap historik në modernizimin e mbrojtjes shqiptare”, - u shpreh ministri Nuçi.

Ai shprehu mirënjohjen ndaj Shteteve të Bashkuara për mbështetjen e vazhdueshme në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit.

“Mirënjohje Shteteve të Bashkuara të Amerikës për partneritetin e palëkundur strategjik dhe mbështetjen e vazhdueshme në ndërtimin e një mbrojtjeje më të fortë për Shqipërinë dhe rajonin më gjerë. Kjo mbështetje do të përshejtojë modernizimin e kapaciteteve tona ushtarake, do të rrisë gatishmërinë operacionale dhe do të forcojë kontributin e Shqipërisë për sigurinë kolektive të Aleancës”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

Programi **Foreign Military Financing (FMF)** është një nga instrumentet më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak të Shteteve të Bashkuara me vendet aleate. Për Shqipërinë, ky financim përfaqëson jo vetëm një mbështetje financiare, por edhe një garanci për vazhdimësinë e transformimit të Forcave të Armatosura në përputhje me standardet më të avancuara të NATO-s.



302 MILIONË DOLLARË NGA SHBA PËR MODERNIZIMIN E MBROJTJES SHQIPTARE

Investimi prej 302 milionë dollarësh pritet të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operacionale, përmirësimin e gatishmërisë së strukturave ushtarake, zhvillimin e aftësive moderne mbrojtëse dhe fuqizimin e rolit të Shqipërisë si një kontribuuese aktive në sigurinë kolektive të Aleancës Atlantike.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje shënon një tjetër etapë në marrëdhëniet e shkëlqyera shqiptaro-amerikane dhe konfirmon se partneriteti strategjik mes dy vendeve mbetet një nga shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare dhe të stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në Gjenova të Italisë, në Divizionin e Anijeve Detare të kompanisë prestigjioze italiane FINCANTIERI, është hedhur një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit strategjik mes Shqipërisë dhe Italisë në fushën e industrisë detare dhe mbrojtjes.

Gjatë ceremonisë së zhvilluar në ambientet e kompanisë FINCANTIERI, u nënshkruan Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë **“Fincantieri Albania”**, një strukturë e re që synon të sjellë një dimension të ri në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe teknologjike të Shqipërisë në sektorin detar.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nuçi, përmes një publikimi të tij, e cilësoi këtë partneritet si një investim të rëndësishëm për të ardhmen e industrisë detare shqiptare.

“Ky partneritet përfaqëson një investim të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë detare shqiptare, transferimin e teknologjisë, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese në vend”, - u shpreh ministri Nuçi.

Sipas tij, Shqipëria po vijon të ndërtojë partneritete të qëndrueshme me liderët ndërkombëtarë të industrisë, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin ekonomik dhe duke kontribuar në forcimin e sigurisë kombëtare.

Shoqëria **“Fincantieri Albania”** do të ketë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kantierit detar të Pashalimanit pas procesit të modernizimit të tij, duke sjellë standarde të reja teknologjike dhe profesionale në

Shqipëri-Itali, një kapitull i ri për industrinë detare të mbrojtjes Nënshkruhet akti i themelimit të **“Fincantieri Albania”**, investim strategjik për zhvillimin e kantierit të Pashalimanit



këtë strukturë me rëndësi strategjike për vendin.

Gjithashtu, kjo kompani do të angazhohet në mbikëqyrjen e ndërtimit të anijeve me gjatësi deri në 82 metra dhe me zhvendosje deri në 700 tonë, të cilat do të synojnë si tregun vendas, ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Krijimi i **“Fincantieri Albania”** përbën një tjetër hap konkret në drejtim të zhvillimit të industrisë së



mbrojtjes në Shqipëri, duke forcuar bashkëpunimin me një prej kompanive më të njohura botërore në sektorin e ndërtimit detar dhe duke hapur perspektiva të reja për rritjen e kapaciteteve kombëtare. Ky partneritet mes Shqipërisë dhe Italisë vjen si dëshmi e marrëdhënieve të konsoliduara mes dy vendeve aleate, të mbështetura mbi besimin reciprok, interesat strategjike dhe angazhimin e përbashkët për një siguri më të fortë në hapësirën euroatlantike.

Shqipëri-Itali, partneritet i konsoliduar në mbrojtje dhe siguri

Ministrat Nufi dhe Crosetto riafirmojnë angazhimin për forcimin e bashkëpunimit strategjik

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, zhvilloi një takim me ministrin e Mbrojtjes së Italisë, z. Guido Crosetto, ku në fokus të diskutimeve ishte forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Biseda mes dy ministrave u përqendrua në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, me vëmendje të veçantë në rritjen e ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura, shkëmbimin e eksperiencave, si dhe në identifikimin e mundësive të reja për bashkëpunim në industrinë e mbrojtjes.

Ministri Nufi vlerësoi rolin e Italisë si një partner strategjik dhe një aleate të rëndësishme të Shqipërisë në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Ai theksoi se partneriteti i ngushtë mes dy vendeve përbën një faktor të rëndësishëm në përballimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë dhe në garantimin e stabilitetit rajonal.

Gjatë takimit u riafirmua vizioni i përbashkët i Shqipërisë dhe Italisë për një rajon më të sigurt dhe një Evropë më të qëndrueshme e më të fortë. Dy ministrat vlerësuan rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm në kuadër të NATO-s, duke nënvizuar angazhimin e të dy vendeve për ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Në këtë kuadër, palët rikonfirmuan përkushtimin për forcimin e kontributit në misionet ndërkombëtare, mbështetjen e përpjekjeve të përbashkëta për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe rritjen e kapaciteteve mbrojtëse përballë sfidave të reja të sigurisë.

Marrëdhëniet e veçanta mes Shqipërisë dhe Italisë në fushën e mbrojtjes vijojnë të mbeten një shembull i bashkëpunimit të ngushtë mes aleatëve të NATO-s, duke u zhvilluar mbi bazën e besimit të ndërsjellë, interesave të përbashkëta dhe angazhimit për sigurinë euroatlantike.



Përgatitje intensive për certifikimin e Grup-Batalionit të Këmbësores së Lehtë sipas standardeve të NATO-s

Në Batalionin e Këmbësores së Lehtë të Forcës Tokësore po zhvillohet një trajnim i përbashkët me ekipet e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, në kuadër të përgatitjeve për stërvitjen certifikuese të Grup-Batalionit të Këmbësores së Lehtë, e planifikuar të zhvillohet gjatë muajit shtator.

Ky trajnim është fokusuar në disa fusha kyçe të aftësive operacionale, përfshirë mirëmbajtjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve, mbështetjen shëndetësore të nivelit **ROL-2**, si dhe përdorimin e sistemeve të mortajave.

Gjatë këtij aktiviteti, efektivët shqiptarë dhe specialistët amerikanë po shkëmbejnë eksperiencën, praktika profesionale dhe procedurat operacionale, me synim rritjen e kapaciteteve të përbashkëta dhe përgatitjen sa më të plotë për procesin e certifikimit.

Bashkëpunimi me ekipet e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit përbën një tjetër dëshmi të partneritetit të qëndrueshëm strategjik mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Përmes këtyre trajnimeve të përbashkëta, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vijojnë të forcojnë ndërveprueshmërinë me forcat aleate, të rrisin gatishmërinë operacionale dhe të konsolidojnë përmeshjen e standardeve të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Përgatitja e Grup-Batalionit të Këmbësores së Lehtë për stërvitjen certifikuese të shtatorit është një proces i rëndësishëm në rrugën e rritjes së aftësive operacionale dhe kontributit të Shqipërisë në misionet dhe angazhimet e përbashkëta të NATO-s.

Forca Tokësore dhe Garda Kombëtare e Nju Xhersit, trajnim i përbashkët për rritjen e kapaciteteve operacionale



“Made in Albania” për mbrojtjen kombëtare

Fillimi i një epoke të re për Forcat e Armatosura

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga importues të pajisjeve ushtarake drejt ndërtimit të një industrie kombëtare të mbrojtjes.

Ky është mesazhi kryesor që përcjell dorëzimi i 40 mjeteve të para taktike të prodhuara në Shqipëri, sipas standardeve të NATO-s. Për shumë vite, modernizimi i Forcave të Armatosura Shqiptare është mbështetur në blerjen e mjeteve dhe pajisjeve nga partnerët strategjikë.

Sot, për herë të parë pas dekadash, vendi po tenton të ndërtojë një hallkë të munguar të sigurisë kombëtare: **kapacitetin vendas të prodhimit ushtarak.**

Ky zhvillim nuk duhet parë vetëm si një sukses industrial apo ekonomik. Në realitet, ai prek një nga shtyllat më të rëndësishme të mbrojtjes moderne: **autonominë strategjike në mbështetjen logjistike të forcave ushtarake.**

Mësimet e luftës në Ukrainë

Nëse para vitit 2022 shumë shtete e konsideronin industrinë ushtarake një sektor që mund të mbështetej te tregu ndërkombëtar, lufta në Ukrainë ndryshoi rrënjësisht këtë perceptim.

Konflikti tregoi se fuqia ushtarake nuk matet vetëm me numrin e tankeve, avionëve apo raketave. Ajo matet edhe me aftësinë për t'i prodhuar, riparuar dhe zëvendësuar ato në kohë krize.

Shumë vende europiane u përballën me mungesa municionesh, pjesësh këmbimi dhe automjeteve ushtarake, sepse zinxhirët globalë të furnizimit u ndërprënë ose u ngadalësuan. Pikërisht për këtë arsye, NATO dhe Bashkimi European kanë nisur një politikë të re për fuqizimin e industrive kombëtare të mbrojtjes.

Në këtë panoramë, edhe Shqipëria po ndërton gradualisht kapacitetet e saj.

Çfarë përfaqësojnë realisht 40 automjetet?

Në pamje të parë, numri 40 mund të mos duket i madh. Por rëndësia e tyre nuk qëndron te sasia.

Ajo që ka peshë strategjike është fakti se këto mjete janë prodhuar në Shqipëri sipas standardeve të NATO-s. Kjo do të thotë se ato janë projektuar për të qenë të ndërveprueshme me sistemet logjistike të Aleancës dhe për të përmbushur kërkesa teknike të krahasueshme me ato të vendeve aleate.

Në praktikë, kjo krijon disa avantazhe: ul varësinë nga furnizuesit e huaj, garanton mirëmbajtje më të shpejtë, krijon kapacitete riparimi në territorin kombëtar, redukon kostot afatgjata dhe rrit gatishmërinë operationale të njësive.

Në doktrinën ushtarake, logjistika është shpesh faktori që përcakton suksesin ose dështimin e një force në operacion. Një automjet i prodhuar në vend nuk është vetëm një mjet transporti, ai është një element i qëndrueshmërisë së mbrojtjes kombëtare.

Industria e mbrojtjes nuk prodhon vetëm armë

Një keqkuptim i zakonshëm është se industria ushtarake prodhon vetëm sisteme armësh.

Në fakt, mbi 70 për qind e vlerës së saj lidhet me sektorë civilë të teknologjisë: mekanikë të avancuar, elektronikë, sisteme komunikimi, softuerë, inteligjencë artificiale, materiale kompozite dhe automatizim.

Prandaj, çdo investim në industrinë e mbrojtjes krijon një efekt zinxhir në ekonomi. Ai nxit universitete, qendra kërkimore, kompani të teknologjisë së informacionit, prodhues mekanikë dhe ndërmarrje të vogla e të mesme që bëhen pjesë e zinxhirit të furnizimit.

Për një ekonomi si ajo shqiptare, kjo është ndoshta vlera më e madhe afatgjatë.

Standardet e NATO-s nuk janë vetëm një etiketë

Në deklaratat publike është theksuar se automjetet janë



prodhuar sipas standardeve të NATO-s. Kjo nuk është një formulë protokollare. Standardet e NATO-s (STANAG) janë një grup kërkesash teknike dhe procedurale që garantojnë ndërveprueshmërinë mes ushtrive aleate.

Ato përfshijnë elemente si siguria strukturore, komunikimet, mirëmbajtja, furnizimi, ergonomia, mbrojtja balistike dhe integrimi me sistemet e tjera ushtarake.

Për një kompani shqiptare, përmbushja e këtyre standardeve është një hap drejt hyrjes në tregjet ndërkombëtare të mbrojtjes.

Nga automjetet drejt teknologjive inteligjente

Luftërat e viteve të fundit kanë treguar se dronët kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e zhvillimit të operacioneve ushtarake.

Sot, edhe ushtri me buxhete shumë më të mëdha po investojnë miliarda euro në sisteme pa pilot, inteligjencë artificiale dhe luftë elektronike.

Nëse industria shqiptare arrin të zhvillojë kompetenca në këto fusha, vendi nuk do të jetë më vetëm përdorues i teknologjisë së importuar, por pjesë e ekosistemit teknologjik të mbrojtjes.

Megjithatë, ky është objektiv që kërkon investime të vazhdueshme në kërkim-shkencë, laboratorë testimi, certifikime dhe burime njerëzore shumë të specializuara.

Mbrojtja kundërajrore, një dimension strategjik

Përvoja e konflikteve të fundit ka treguar se kontrolli i hapësirës ajrore është vendimtar. Sulmet me raketa, dronë dhe municione endacake kanë bërë që mbrojtja kundërajrore të rikthehet në qendër të planifikimit ushtarak.

Për Shqipërinë, e cila është pjesë e sistemit të mbrojtjes kolektive të NATO-s, investimi në këtë fushë rrit jo vetëm sigurinë kombëtare, por edhe kontributin ndaj arkitekturës së mbrojtjes së Aleancës.

A mund të eksportojë Shqipëria pajisje ushtarake?

Deklarata se produkte shqiptare mund të përdoren në

të ardhmen edhe nga ushtria amerikane është një objektiv ambicioz.

Realizimi i tij nuk varet vetëm nga cilësia e produktit.

Tregu ndërkombëtar i mbrojtjes karakterizohet nga konkurrencë e fortë, procedura të gjata certifikimi, kërkesa për besueshmëri shumëvjeçare dhe standarde të larta sigurie.

Megjithatë, historia tregon se shumë kompani që sot furnizojnë ushtri të mëdha kanë nisur duke prodhuar komponentë, automjete ndihmëse ose pajisje logjistike.

Në këtë kuptim, rëndësi ka hyrja në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, jo domosdoshmërisht prodhimi i sistemeve më komplekse që në fazën e parë.

Përtej ceremonisë

Dorëzimi i 40 mjeteve taktike nuk është fundi i një projekti, është fillimi i një procesi.

Suksesi i tij do të matet jo vetëm me numrin e automjeteve që do të prodhohen në vitet e ardhshme, por me aftësinë për të ndërtuar një industri të qëndrueshme, konkurruese dhe inovative.

Shqipëria ka përpara disa sfida, zhvillimin e burimeve njerëzore të specializuara, rritjen e investimeve në kërkim dhe zhvillim, zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe sigurimin e certifikimeve ndërkombëtare. Nëse këto elemente ecin paralelisht me modernizimin e Forcave të Armatosura, vendi mund të ndërtojë një sektor të mbrojtjes që nuk do të shërbejë vetëm për nevojat kombëtare, por edhe si një kontribues i besueshëm në ekosistemin industrial të NATO-s.

Në fund, rëndësia e këtij momenti nuk qëndron vetëm te fakti se ushtria shqiptare mori 40 automjete të reja.

Rëndësia qëndron te ndryshimi i filozofisë së zhvillimit, nga një model i mbështetur kryesisht te importi, drejt një modeli që synon të prodhojë, të inovojë dhe të krijojë vlerë të shtuar në vend. Në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, kjo qasje mund të shndërrohet në një nga investimet më të rëndësishme strategjike të Shqipërisë në dekadat e ardhshme.



Intervistoi: **ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve

MAJOR ILIR KALLANXHI: Uniforma të mëson të udhëheqësh me shembull, ndërsa muzika ushtarake të mëson të përfaqësosh dinjitetin e kombit

Në Forcat e Armatosura ka oficerë, rrugëtimi profesional i të cilëve përmbledh në mënyrë domethënëse transformimin e ushtrisë shqiptare gjatë dy dekadave të fundit. Njëri prej tyre është **Major Ilir Kallanxhi**, një oficer që ka ndërtuar karrierën e tij duke kaluar nga njësitë operacionale në strukturat ceremoniale dhe më pas në drejtimin e formacioneve artistike të Forcave të Armatosura.

I diplomuar në **Administrim Biznesi**, me profil **Menaxhim**, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, ai paralelisht përfundoi formimin ushtarak në **Akademinë Ushtarake “Skënderbej”**, duke ndërtuar një profil profesional ku ndërthuren aftësitë drejtuese, administrimi dhe kultura ushtarake.

Karriera e tij nisi në **Batalionin e Parë të Këmbëorisë Alpine** në Vaun e Dejës, për të vijuar në **Batalionin e Mbështetjes të Shtabit të Përgjithshëm**, fillimisht në Kompaninë Ceremoniale, më pas si komandant toge, specialist logjistike dhe armatimi, komandant i **Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura**, ndërsa sot mban detyrën e **Shefit të Sektorit të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura**, me gradën **Major**.

Në këtë intervistë për **Gazetën “Ushtria”**, ai rrëfen rrugëtimin e tij profesional, sfidat e drejtimit, rëndësinë e disiplinës ushtarake dhe misionin që kanë sot strukturat artistike në përfaqësimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Major Kallanxhi, si lindi dëshira për të zgjedhur profesionin e ushtarakut?

Që në vitet e rinisë kam besuar se profesioni ushtarak është një nga format më fisnike të shërbimit ndaj vendit. Uniforma nuk është thjesht një simbol, ajo përfaqëson përgjegjësi, disiplinë dhe gatishmëri për të qenë në shërbim të qytetarëve në çdo kohë. Kjo ishte arsyeja që zgjodha të ndërtoj jetën time profesionale në Forcat e Armatosura.

Ju përfunduat njëkohësisht studimet civile dhe ato ushtarake. Sa e vështirë ishte kjo periudhë?

Ishte një periudhë intensive. Kombinimi i studimeve universitare në Menaxhim me formimin ushtarak kërkonte organizim, disiplinë dhe përkushtim të madh. Megjithatë, pikërisht kjo më ndihmoi të krijoja një bazë të fortë profesionale. Njohuritë në administrim më kanë shërbyer vazhdimisht në drejtimin e strukturave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Çfarë ndikimi pati Akademia Ushtarake në formimin tuaj?

Akademia ishte vendi ku u formuan jo vetëm njohuritë profesionale, por edhe karakteri. Aty mësohet rëndësia e disiplinës, e respektit për hierarkinë, e përgjegjësisë ndaj detyrës dhe e punës në ekip. Janë vlera që të shoqërojnë gjatë gjithë karrierës.

Detyra juaj e parë ishte në Batalionin e Parë të Këmbëorisë Alpine. Çfarë kujtoni nga ajo periudhë?



Ishte shkolla më e mirë praktike. Në njësi të tilla mëson të përballosh terrene të vështira, kushte klimatike të ndryshme dhe ritme të larta pune. Ishte periudha kur kuptova se çdo oficer duhet të fitojë respektin e vartësve përmes shembullit personal.

Cilat janë cilësitë që fiton një ushtarak në një repart operacional?

Mëson të marrësh vendime të shpejta, të ruash qetësinë në situata të vështira dhe të mbështetesh tek ekipi. Këto janë aftësi që më kanë shoqëruar në çdo detyrë të mëvonshme.

Më pas kaluat në Kompaninë Ceremoniale. Si ndryshon ky shërbim?

Ceremoniali është fytyra institucionale e Forcave të Armatosura. Çdo lëvizje, çdo komandë dhe çdo detaj duhet të jetë perfekt. Përfaqëson shtetin shqiptar në aktivitetet më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Çfarë kërkon drejtimi i një toge ceremoniale?

Kërkon disiplinë të jashtëzakonshme, përgatitje të vazhdueshme dhe aftësi për të motivuar personelin.



Perfeksioni nuk arrihet rastësisht; ai është rezultat i punës së përditshme.

Çfarë mësuat si komandant?

Se drejtimi nuk është privilegj, por përgjegjësi. Një komandant duhet të jetë gjithmonë i drejtë, i paanshëm dhe i gatshëm të marrë përgjegjësi për vendimet e tij.

Si ndikoi eksperiencia në logjistikë në formimin tuaj?

Më bëri të kuptoj se suksesi i çdo strukture ushtarake varet edhe nga administrimi korrekt i burimeve. Logjistika është shtylla që mban funksionimin e çdo njësie.

Si erdhi kalimi në drejtimin e Orkestrës Frymore?

Ishte një sfidë krejtësisht e re. Përvoja ime organizative më ndihmoi të drejtoj një strukturë ku ndërthuren disiplina ushtarake dhe arti.

Çfarë përfaqëson muzika ushtarake?

Është pjesë e traditës së ushtrive moderne. Muzika ushtarake shoqëron ceremonitë shtetërore, nderon historinë, motivon trupat dhe përçon mesazhe uniteti.

Cila është sfida më e madhe në drejtimin e një orkestre ushtarake?

Të harmonizosh disiplinën ushtarake me krijimtarinë artistike. Këto dy elemente plotësojnë njëri-tjetrin.

Si përgatitet një ceremoni shtetërore?

Pas çdo ceremonie që publiku sheh për disa minuta, fshihen javë të tëra planifikimi, prova, koordinimi dhe angazhimi i dhjetëra ushtarakëve.

Çfarë emocionesh përjetoni gjatë ceremonive kombëtare?

Janë momente krenarie. Kur interpretohet himni



kombëtar apo zhvillohen ceremoni në prani të autoriteteve më të larta të vendit dhe partnerëve ndërkombëtarë, ndien peshën e përgjegjësisë që përfaqëson uniforma.

Çfarë rëndësie ka përfaqësimi ceremonial?

Është një element diplomacie ushtarake. Përmes ceremonive, Shqipëria prezanton profesionalizmin dhe seriozitetin e Forcave të Armatosura.

Si kanë ndryshuar Forcat e Armatosura ndër vite?

Kanë bërë hapa të rëndësishëm në modernizim,

profesionalizëm dhe ndërveprim me aleatët e NATO-s. Sot standardet janë shumë më të larta dhe kërkesat për personelin janë më të mëdha.

Çfarë roli luan teknologjia?

Është bërë pjesë e pandashme e çdo procesi, nga planifikimi deri te administrimi dhe komunikimi.

Si e motivoni personelin?

Duke qenë pranë tyre, duke dëgjuar problemet dhe duke krijuar frymë bashkëpunimi. Motivimi nuk vjen vetëm nga urdhri, por edhe nga besimi.

Çfarë cilësish duhet të ketë një oficer i ri?

Profesionalizëm, integritet, dëshirë për të mësuar dhe aftësi për të punuar në ekip.

Çfarë do të thotë grada Major për ju?

Është një vlerësim për punën e bërë, por mbi të gjitha një përgjegjësi edhe më e madhe për të udhëhequr dhe për të qenë shembull.

Si e përkufizoni lidershipin?

Lidershipi nuk matet me gradën, por me aftësinë për të frymëzuar njerëzit që punojnë me ty.

Cilat janë objektivat tuaja në detyrën aktuale?

Të vazhdojmë rritjen e cilësisë artistike dhe organizative të Orkestrës Simfonike, duke ruajtur traditën dhe duke sjellë risi në aktivitetet institucionale.

Çfarë ju bën më krenar në karrierën tuaj?

Fakti që kam pasur mundësinë të shërbej në detyra të ndryshme dhe të kontribuoj në secilën prej tyre me përkushtim maksimal.

Si e shihni të ardhmen e Forcave të Armatosura?

Jam optimist. Modernizimi, profesionalizmi dhe integrimi në strukturat euroatlantike do ta bëjnë ushtrinë shqiptare gjithnjë e më të aftë për të përmbushur misionet e saj.

Mesazhi juaj për ushtarakët e rinj dhe lexuesit e Gazetës “Ushtria”?

Çdo brez ka detyrën të lërë një ushtri më të fortë se ajo që gjeti. Të rinjve u them të mos e shohin uniformën vetëm si një profesion, por si një mision. Përkushtimi, ndershmëria, studimi i vazhdueshëm dhe respekti për institucionin janë çelësat e suksesit në karrierën ushtarake. Forcat e Armatosura janë një familje e madhe, ku secili kontribuon sipas detyrës së tij për sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Shërbimi ndaj atdheut është një nder që kërkon sakrificë, por njëkohësisht të jep krenarinë më të madhe: të jesh pjesë e mbrojtjes së vendit dhe e përfaqësimit të tij me dinjitet, brenda dhe jashtë kufijve.





NUK IKIN POETËT...

ATA THJESHT IA DORËZOJNË FJALËN PËRJETËSISË

Arben Duka, skënderbegasi që e ktheu
penën në mision dhe fjalën në atdhe

“Njeriu jeton aq sa jeton emri i tij në kujtesën e njerëzve. Poeti jeton edhe më gjatë, sepse ai banon në zemrat e atyre që nuk i ka njohur kurrë”

Ka njerëz që e shkruajnë historinë me vendime. Të tjerë e mbrojnë atë me armë. Ka edhe nga ata të rrallët që e ruajnë me fjalë. Në një komb të vogël si yni, ku kujtesa shpesh vihet në provë dhe koha tenton të zbehë edhe figurat më të ndritura, largimi i një njeriu si Arben Duka nuk është vetëm humbja e një poeti. Është një çast reflektimi për mënyrën se si ndërtohen vlerat që i mbijetojnë kohës.

Një lajm i tillë nuk kërkon zhurmë. Nuk ka nevojë për tituj të mëdhenj apo për fjalë të tepërta. Mjafton emri. Mjafton kujtesa që ai zgjon. Mjafton vepra që lë pas. Sepse ka personalitete që nuk identifikohen vetëm me profesionin e tyre, por me ndikimin që ushtrojnë mbi ndërgjegjen e një shoqërie. Arben Duka ishte një prej tyre.

**ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve**

Në letërsinë shqiptare ai do të kujtohet si poeti i ndjenjës, si mjeshtri i satirës, si autori i mijëra teksteve të këngëve që u bënë pjesë e memories kolektive të shqiptarëve.

Por për familjen e madhe të Forcave të Armatosura ai mbetet edhe diçka tjetër, po aq e rëndësishme: një bir i Shkollës Ushtarake “Skënderbej” dhe i Akademisë Ushtarake, institucione që nuk formojnë vetëm profesionistë të mbrojtjes, por mbi të gjitha karaktere. Kjo është një nga idetë qendrore që përshkon edhe tekstin bazë: formimi i tij ushtarak nuk ishte një episod biografik, por një element që shpjegon personalitetin dhe etikën e tij krijuese.

Shpesh flasim për ushtrinë duke menduar vetëm për uniformën, armët, stërvitjen dhe misionet. Janë shtyllat e padiskutueshme të saj. Por ushtria është njëkohësisht një shkollë qytetarie. Ajo është vendi ku mësohet se liria nuk është një e drejtë e dhënë përgjithmonë, por një përgjegjësi që kërkon përgatitje, disiplinë dhe sakrificë. Mësohet se fjala e dhënë ka peshë, se nderi nuk negociohet dhe se detyra nuk matet me interesin personal. Këto nuk janë vetëm parime ushtarake. Janë themelet mbi të cilat ndërtohet çdo shoqëri e shëndetshme. Prandaj nuk është rastësi që nga bankat e institucioneve ushtarake shqiptare kanë dalë jo vetëm komandantë e drejtues, por edhe studiues, profesorë, diplomatë, sportistë dhe artistë.

Uniforma nuk e kufizon horizontin e njeriut, ajo e disiplinon atë. Nuk e zvogëlon krijimtarinë; përkundrazi, i jep asaj përgjegjësi. Arben Duka ishte prova më e bukur e kësaj të vërtete. Ai nisi rrugën e tij në një institucion ku të rinjtë edukoheshin për të mbrojtur vendin.

Më vonë zgjodhi një tjetër armë. Penën. Por ndryshoi vetëm mjeti. Jo misioni. Sepse ka njerëz që mbrojnë kufijtë fizikë të atdheut dhe ka të tjerë që mbrojnë kufijtë shpirtërorë të tij. Njëri ruan territorin. Tjetri ruan gjuhën, kujtesën, kulturën dhe ndërgjegjen kombëtare. Të dyja këto misione janë po aq të domosdoshme për mbijetesën e një kombi.

Në këtë kuptim, Arben Duka mbeti ushtar deri në fund të jetës. Jo ushtar me grada. Jo ushtar me dekorata. Por ushtar i së vërtetës. Ushtar i gjuhës shqipe.

Ushtar i ndërgjegjes qytetare.

Në kohën kur fjala shpesh përdoret për të manipuluar, për të ndarë ose për të fshehur të vërtetën, ai zgjodhi ta përdorte për të ndriçuar. Nuk e vuri talentin në shërbim të modës kalimtare. Nuk e shiti bindjen për duartrokitje të lehta. Nuk iu nënshtroi konformizmit. Ai mbeti besnik ndaj lexuesit dhe ndaj vetes, duke e trajtuar letërsinë si përgjegjësi morale. Ky është edhe një nga mesazhet më të forta të tekstit burimor.

Në këtë pikë, figura e Arben Dukës fiton një dimension që shkon përtej letërsisë. Ajo bëhet një model qytetarie. Një dëshmi se edukimi ushtarak nuk kufizohet në aftësinë për të komanduar një repart, por shtrihet në aftësinë për të komanduar veten, për të ruajtur integritetin dhe për t'i shërbyer vendit në çdo fushë të jetës.

Sot, kur shpesh dëgjojmë të flitet për krizën e modeleve, për mungesën e autoriteteve morale dhe për relativizimin e vlerave, biografi të tilla marrin një rëndësi të veçantë. Ato dëshmojnë se Shqipëria ka ditur të formojë njerëz që nuk kanë kërkuar lavdi personale, por kanë ndërtuar një trashëgimi që u përket të gjithëve. Në historinë e çdo ushtrie moderne ekziston një bindje themelore, fuqia e saj nuk matet vetëm me armatimin, por me cilësinë e njerëzve që ajo formon. Armatimet ndryshojnë. Teknologjitë zhvillohen. Doktrinat ushtarake përshtaten me kohën. Por karakteri mbetet arma më e fortë e një kombi.

Karakter i ishte edhe arma më e fortë e Arben Dukës. Ai nuk e ngriti zërin për të imponuar veten. Nuk kërkoi privilegje. Nuk ndërtoi mite rreth emrit të tij.

Puno i në heshtje, me një disiplinë që rrallë shihet në botën e artit, duke lënë pas një krijimtari të jashtëzakonshme që sot përbën një pasuri të kulturës shqiptare.

Mbi pesëdhjetë libra poetikë, mijëra poezi, mijëra tekste këngësh dhe një kontribut i spikatur në satirë, nuk janë thjesht statistika. Ato janë dëshmi e një jete të jetuar me përkushtim ndaj fjalës dhe ndaj shoqërisë.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron madhështia e figurave si Arben Duka.

Ata nuk na mësojnë vetëm si të shkruajmë. Na mësojnë si të jetojmë me dinjitet.

Kur fjala bëhet shërbim ndaj atdheut

Historia e kombeve nuk shkruhet vetëm nga ata që fitojnë beteja. Ajo shkruhet edhe nga ata që i japin një populli vetëdijen për atë që është, për atë që ka qenë dhe për atë që duhet të mbetet. Në këtë kuptim, letërsia nuk është një zbukurim i jetës kombëtare, ajo është një nga shtyllat mbi të cilat ngrihet identiteti i saj.

Një ushtri mbron kufijtë e shtetit. Kultura mbron kufijtë e shpirtit. Kur njëra dobësohet, rrezikohet siguria, kur dobësohet tjetra, rrezikohet vetë ekzistenca morale e kombit.

Prandaj, njerëz si Arben Duka nuk mund të maten vetëm me numrin e librave që botuan apo me çmimet që fituan. Vlera e tyre qëndron në ndikimin që ushtruan mbi ndërgjegjen e shoqërisë. Ata i mësuari shqiptarët të besojnë te fuqia e fjalës së ndershme, te bukuria e gjuhës shqipe dhe te nevoja për të mbrojtur vlerat njerëzore edhe në kohët më të vështira.

Poezia e Arben Dukës nuk ishte arratisje nga realiteti.

Uniforma nuk e kufizon horizontin e njeriut, ajo e disiplinon atë. Nuk e zvogëlon krijimtarinë; përkundrazi, i jep asaj përgjegjësi. Arben Duka ishte prova më e bukur e kësaj të vërtete. Ai nisi rrugën e tij në një institucion ku të rinjtë edukoheshin për të mbrojtur vendin.

Ishte një mënyrë për ta përballuar atë. Kur shkruante për dashurinë, ai nuk fliste vetëm për ndjenjën mes dy njerëzve. Fliste për besimin, mirëkuptimin dhe aftësinë e njeriut për të kapërcyer ndarjet. Kur shkruante satirë, nuk synonte të poshtëronte askënd. Ai godiste veset, jo njeriun, denonconte hipokrizinë, arrogancën dhe mediokritetin, duke përdorur humorin si një instrument ndërgjegjësimi. Pikërisht ky ekuilibër mes ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë e bëri krijimtarinë e tij të dashur për breza të tërë lexuesish.

Në një epokë kur informacioni qarkullon me shpejtësi, por mendimi shpesh mbetet sipërfaqësor, vepra e Arben Dukës na kujton se fjala ka peshë. Ajo mund të ndërtojë ose të shkatërrojë, të bashkojë ose të ndajë. Për këtë arsye, ai e trajtoi gjithmonë shkrimin si një akt përgjegjësie qytetare.

Ky është një mësim që tejkalon kufijtë e letërsisë. Është një mësim për çdo profesion. Për çdo institucion. Për çdo ushtarak.

Në Forcat e Armatosura, përgjegjësia nuk matet vetëm me gradën që mban mbi supe, por me besimin që të është dhënë. E njëjta gjë vlen edhe për intelektualin. Talenti nuk është privilegj. Është detyrim. Është përgjegjësi ndaj shoqërisë që të ka formuar. Arben Duka e kuptoi këtë më mirë se shumë të tjerë.

Ai nuk e përdori kurrë talentin për të ndërtuar kultin e vetes. E përdori për të ndriçuar jetën e të tjerëve.

Kjo është arsyeja pse sot largimi i tij nuk ndihet vetëm në qarqet letrare. Ai ndihet edhe në familjen ushtarake shqiptare. Sepse ajo e njeh si një prej bijve të saj, një njeri që dëshmoi se idealet e fituara në bankat e Shkollës “Skënderbej” dhe të Akademisë Ushtarake mund të shoqërojnë një njeri gjatë gjithë jetës, pavarësisht rrugës që ai zgjedh më pas. Kjo ide përshkon qartë edhe tekstin bazë, ku theksohet se ai e zëvendësoi armën me penën, por jo misionin e shërbimit ndaj vendit.

Sot, kur Shqipëria është pjesë e NATO-s dhe Forcat tona të Armatosura kontribuojnë në sigurinë kolektive përkrah aleatëve, është e rëndësishme të kujtojmë se forca e një ushtrie nuk ndërtohet vetëm mbi profesionalizmin operacional. Ajo mbështetet edhe mbi kulturën, historinë dhe sistemin e vlerave që formojnë ushtarakun si qytetar.

Një ushtarak nuk është vetëm mbrojtës i territorit. Ai është ambasador i identitetit kombëtar. Ai përfaqëson historinë, traditën dhe kulturën e vendit të tij.

Prandaj, kur Gazeta “**Ushtria**” nderon figura si Arben Duka, nuk kryen thjesht një detyrim moral ndaj një ish-skënderbegasi. Ajo afirmon një të vërtetë shumë më të

Në Forcat e Armatosura, përgjegjësia nuk matet vetëm me gradën që mban mbi supe, por me besimin që të është dhënë. E njëjta gjë vlen edhe për intelektualin. Talenti nuk është privilegj. Është detyrim. Është përgjegjësi ndaj shoqërisë që të ka formuar. Arben Duka e kuptoi këtë më mirë se shumë të tjerë.

madhe: se institucioni ushtarak shqiptar ka qenë dhe mbetet një vatër ku formohen personalitete që i shërbejnë kombit në shumë fusha të jetës.

Nga këto banka kanë dalë komandantë që kanë mbrojtur vendin. Kanë dalë diplomatë që kanë përfaqësuar Shqipërinë. Kanë dalë studiues që kanë pasuruar dijen. Kanë dalë sportistë që kanë ngritur flamurin kombëtar.

Dhe kanë dalë poetë që kanë mbrojtur shpirtin e këtij kombi. Arben Duka ishte njëri prej tyre.

Çdo brez ka nevojë për shembuj. Jo për mite të largëta. Por për njerëz realë.

Për njerëz që tregojnë se përkushtimi, disiplina, ndershmëria dhe dashuria për atdheun nuk janë fjalë të mëdha, por mënyra konkrete për ta jetuar jetën.

Jeta e Arben Dukës na kujton se njeriu nuk bëhet i pavdekshëm sepse jeton gjatë. Bëhet i pavdekshëm kur arrin të lërë pas një vepër që vazhdon të flasë edhe pasi zëri i tij është shuar.

Kjo është arsyeja pse sot, nuk po i themi lamtumirë vetëm një poeti. Por përulemi me respekt para një njeriu që e kuptoi se shërbimi ndaj Shqipërisë nuk mbaron me përfundimin e një karriere, as me heqjen e uniformës. Ai vazhdon sa herë që fjala ndërton, frymëzon dhe edukon.

Prandaj, për Arben Dukën, shprehja “**In Memoriam**” duket e pamjaftueshme.

“In Memoriam” u përket atyre që jetojnë vetëm në kujtesë.

Arben Duka do të vazhdojë të jetojë në librat që do të hapen nga brezat e rinj, në këngët që do të këndohen në skenat shqiptare, në buzëqeshjen që do të sjellë ende satira e tij dhe në çdo varg që do t'i kujtojë këtij kombi se fjala e ndershme është një formë e lartë e atdhedashurisë. Kjo është edhe fryma me të cilën mbyllet teksti bazë, duke e vendosur figurën e tij në vazhdimësinë e traditës ushtarake dhe kulturore shqiptare.

Sot, Gazeta “**Ushtria**” përkulet me respekt përpara kujtimit të ish-skënderbegasit, ushtarakut, poetit dhe intelektualit Arben Duka. Jo vetëm sepse ai ishte pjesë e historisë së institucioneve tona, por sepse dëshmoi se misioni i një ushtaraku nuk kufizohet nga uniforma. Ai jeton në çdo vepër që i shërben Shqipërisë, në çdo fjalë që mbron dinjitetin e saj dhe në çdo brez që frymëzohet të ndërtojë një të ardhme më të mirë.

I përjetshëm, Arben Duka!

Jo si një njeri që u largua, por si një ushtar i fjalës, që do të vazhdojë të qëndrojë në rresht, aty ku nuk arrin koha, në kujtesën e kombit dhe në pavdekësinë e

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Bëj mirë dhe harroje. Nëse e përdor të mirën për t’ia kujtuar tjetrit, nuk ke bërë bamirësi; ke krijuar një borxh. Ndërsa dinjiteti nuk duhet të jetë kurrë peng i një favori.”

Ka shprehje që nuk kanë nevojë për shpjegim, sepse janë vetë një pasqyrë e ndërgjegjes njerëzore. Ato nuk kërkojnë argumente, por guximin për t’u parë në to. Kjo është njëra prej tyre. Ndoshta nuk ka qenë kurrë kaq e lehtë të bësh mirë dhe, njëkohësisht, kaq e vështirë ta harrosh atë.

Jetojmë në një epokë ku pothuajse gjithçka regjistrohet. Çdo arritje fotografohet. Çdo emocion publikohet. Çdo ndihmë dokumentohet. Çdo gjest kërkon dëshmitarë. Madje edhe heshtja duket sikur ka nevojë për një mikrofon. Në këtë qytetërim të ekspozimit, edhe mirësia ka filluar të humbasë privatësinë e saj. Ajo nuk hyn më në jetën e njerëzve nga dera e zemrës, por nga ekrani i telefonit. Nuk matet më me peshën që lehtëson mbi supet e dikujt, por me numrin e pëlqimeve që mbledh. Dhe pikërisht aty fillon drama morale e kohës sonë. Sepse e mira nuk ka vdekur. Ajo vazhdon të ekzistojë. Por gjithnjë e më shpesh nuk është më e lirë.

Shpesh vjen e shoqëruar me një faturë të padukshme. Një ditë, dikush të ndihmon. Kalojnë muaj, ndoshta vite. Pastaj, në një debat, në një konflikt apo në një moment kur ti zgjedh të mos jesh dakord me të, dëgjon fjalinë që rrëzon gjithë madhështinë e atij gjesti: “Mos harro çfarë kam bërë për ty”. Në atë çast nuk shembet vetëm një marrëdhënie. Shembet vetë kuptimi i mirësisë. Sepse ndihma që kërkon të kujtohet nuk është më dhuratë. Është kredi. Dhe kredia gjithmonë pret këste.

Kjo është arsyeja pse njerëzit e urtë të çdo kohe kanë këmbëngulur në një ide që sot duket pothuajse revolucionare: bëj mirë dhe harroje. Harroje, jo sepse nuk ka vlerë. Përkundrazi. Harroje sepse vetëm kështu ajo mbetet e pastër. Mirësia fillon të prishet në momentin që hyn në llogaritë e egos. Ajo nuk ka nevojë të numërohet. Nuk ka nevojë të arkivohet. Nuk ka nevojë të përdoret si argument në bisedat e së nesërmes. Sepse mirësia nuk është investim. Është karakter. Në një kohë kur gjithçka matet me fitim, kjo ide tingëllon pothuajse naive. Shoqëria na mëson të mos japim pa marrë. Të mos investojmë pa kthim. Të mos besojmë pa garanci. Të mos falim pa kushte.

Madje, në mënyrë të pavetëdijshme, kemi filluar ta shohim edhe dashurinë si kontratë. Edhe miqësinë si marrëveshje. Edhe respektin si shkëmbim. Dhe kështu kemi krijuar një botë ku njerëzit nuk pyesin më: “Çfarë mund të bëj për ty?” Por: “Çfarë do të fitoj prej teje?” Në këtë klimë, mirësia bëhet mall. Shitet. Blihet. Ekspozohet. Reklamohet. Por nuk jetohet.

Ka një dallim të madh midis njeriut që ndihmon dhe atij që e bën tjetrin të ndihet borxhli. I pari të ngre. I dyti të mban poshtë. Sepse borxhi moral është ndoshta forma më elegante e robërisë. Ai nuk ka zinxhirë. Nuk ka pranga. Nuk ka gjykata. Por e bën njeriun të ndihet gjithmonë i detyruar. Dhe një njeri që ndihet vazhdimisht borxhli nuk është më plotësisht i lirë. Prandaj dinjiteti nuk duhet të jetë kurrë çmimi i një ndihme. Mund t’i japësh dikujt bukë. Mund t’i japësh punë. Mund t’i japësh kohë. Mund t’i japësh para.

Bëj mirë dhe harroje!

Shoqëria nuk po vuan nga mungesa e mirësisë, por nga kujtesa e saj



Por nëse gjatë gjithë jetës ia kujton këtë, në të vërtetë nuk i ke dhënë asgjë. I ke marrë qetësinë. I ke marrë krenarinë. I ke marrë lirinë për të të parë si të barabartë. Dhe pikërisht këtu fillon varfëria më e madhe e shoqërisë sonë. Jo mungesa e pasurisë. Por mungesa e fisnikërisë. Sepse fisnikëria nuk është të japësh. Fisnikëria është të japësh pa e bërë tjetrin të ulë kokën. Ndoshta kjo është arsyeja pse njerëzit më të mëdhenj në histori nuk mbahen mend vetëm për atë që kanë bërë. Por për mënyrën si e kanë bërë. Ata nuk e shndërruan mirësinë në monument për veten. Ata nuk ndërtuan piedestale mbi nevojën e të tjerëve. Ata ndihmuan dhe vazhduan rrugën. Pa zhurmë. Pa reklamë. Pa kujtesë.

Sot kemi nevojë pikërisht për këtë lloj revolucioni. Jo një revolucion politik. As ekonomik. Por moral. Një revolucion që na mëson se jo çdo gjë duhet të fotografohet. Se jo çdo ndihmë duhet të rrëfehët. Se jo çdo sakrificë duhet të shpallet.

Sepse ka gjëra që humbasin madhështinë në momentin që tregohen. Mirësia është njëra prej tyre. Në fund të jetës nuk do të mbahemi mend për numrin e njerëzve që na thanë “faleminderit”. Do të mbahemi mend për numrin e njerëzve që, falë nesh, nuk u ndien kurrë të detyruar ta thoshin atë. Sepse mirësia më e madhe është ajo që nuk kërkon kujtesë. Ajo nuk ka nevojë për duartrokitje. Nuk pret medalje. Nuk kërkon mirënjohje. Ajo largohet në heshtje, ashtu siç vjen drita në mëngjes. Ndriçon. Ngroh. Dhe nuk pyet kurrë nëse dikush do ta falënderojë për këtë.

Ndoshta ky është testi më i madh i karakterit njerëzor. Jo nëse jemi në gjendje të bëjmë mirë. Por nëse jemi mjaftueshëm të mëdhenj për ta harruar menjëherë atë që kemi bërë. Sepse vetëm atëherë e mira pushon së qeni favor. Dhe bëhet virtyt. Vetëm atëherë njeriu pushon së kërkuari mirënjohje. Dhe fillon të ndërtojë qytetërim. Sepse qytetërimet nuk mbështeten mbi kujtesën e favoreve. Ato ndërtohen mbi kujtesën e vlerave. Dhe ndër të gjitha vlerat që e bëjnë një shoqëri të denjë për të ardhmen, ndoshta më fisnikja mbetet ende ajo që nuk bën zhurmë: **Të bësh mirë... dhe ta harrosh.**

Kur kujtesa shkruhet me zemër

Ka libra që lexohen dhe ka libra që jetohen. Ka vargje që lindin nga frymëzimi i çastit dhe ka poezi që burojnë nga përvoja, nga shërbimi, nga besnikëria ndaj idealeve dhe nga malli për njerëzit me të cilët ke ndarë një pjesë të jetës. Këto të fundit nuk janë thjesht krijime artistike; janë dëshmi të shpirtit njerëzor, kronika të heshtura të një brezi dhe monumente të ngritura me fjalë.

Në historinë e ushtrive të botës, ushtari nuk ka qenë vetëm mbrojtës i kufijve, por edhe ruajtës i kujtesës. Ai ka ditur të shkruajë për betejat, për shokët e armëve, për humbjet dhe fitoret, për idealet që nuk zbehen me kalimin e viteve. Edhe në Shqipëri kjo traditë ka lënë gjurmë të çmuara. Shumë ushtarakë kanë zgjedhur ta përjetësojnë rrugëtimin e tyre jo vetëm në dokumente e fotografi, por edhe në poezi, kujtime dhe libra që mbajnë gjallë historinë njerëzore të uniformës.

Në këtë mozaik kujtese zë vend të veçantë edhe krijimtaria e **nënkolonelit (R) Agim Lika**. Vargjet e tij nuk i drejtohen vetëm një botimi. Ato i drejtohen një institucioni që formoi karaktere, edukoi qytetarë dhe përgatiti breza oficerësh e ushtarakësh që e deshën Shqipërinë me përkushtim. Në

poezinë e tij, Skënderbegas nuk është vetëm një shkollë; është një simbol i edukimit patriotik, një vatër kujtese dhe një identitet që vazhdon të jetojë në ndërgjegjen e atyre që kaluan në bankat e saj.

Në çdo strofë ndihet jehona e oborreve ku u rritën ëndrrat e rinisë, tingulli i hapave të kadetëve, forca e betimeve dhe dashuria për flamurin. Aty kujtesa nuk shfaqet si nostalgji e thjeshtë, por si përgjegjësi morale për të mos lejuar që harresa të mbulojë njerëzit, institucionet dhe vlerat që ndërjuan historinë e ushtrisë shqiptare.

Pikërisht këtë mision përmbush edhe poezia. Ajo nuk kërkon të sfidojë kohën, por ta ndriçojë atë. Nuk synon të idealizojë të kaluarën, por të ruajë thelbin e saj për brezat që vijnë. Kur shkruhet nga njerëz që e kanë jetuar shërbimin me dinjitet, fjala fiton peshën e dëshmisë dhe vargu merr vlerën e një dokumenti shpirtëror.

Vargjet që sjellim në vijim janë pjesë e kësaj trashëgimie. Janë një homazh për bashkudhëtarët e jetës ushtarake, për miqësinë që sfidon vitet, për kujtesën që nuk shuhet dhe për atdhedashurinë që mbetet busulla më e sigurt e çdo

brezi. Sepse, njeriu nuk jeton aq sa i rrahin vitet, por aq sa kujtohen veprat dhe vlerat që ai lë pas.

Shtypi ushtarak shpreh mirënjohjen dhe respektin e tij të veçantë për nënkolonelin (R) Agim Lika, si edhe për të gjithë ushtarakët, në shërbim dhe në rezervë, të cilët, përmes penës, poezisë dhe kujtimeve të tyre, kontribuojnë në ruajtjen e kujtesës historike dhe shpirtërore të Ushtrisë Shqiptare.

Çdo varg i shkruar me ndjenjë, çdo faqe kujtimesh dhe çdo reflektim mbi jetën ushtarake është një pasuri që u përcillet brezave. Këto krijime nuk i përkasin vetëm autorëve të tyre, ato bëhen pjesë e trashëgimisë sonë të përbashkët, duke dëshmuar se vlerat e shërbimit, nderit, sakrificës dhe atdhedashurisë jetojnë edhe përtej uniformës.

Gazeta “Ushtria” do të mbetet gjithmonë një tribunë e hapur për këto zëra, sepse beson se historia e Forcave të Armatosura nuk shkruhet vetëm me dokumente dhe kronika, por edhe me emocionet, kujtimet dhe krijimtarinë e atyre që i kanë shërbyer me besnikëri flamurit kombëtar.



NËNKOLONEL (R) AGIM LIKA

SKËNDERBEGAS, “Pasaporta e vlerave atdhetare”

MOTO

Nuk matet jeta me vitet që kalojnë
Por, me vlerat që lë pas çdo njeri
Kur kujtesa bëhet dritë për brezat
Ajo, merr emrin “Pavdekësi”

Tempulli i Kujtesës

Ky libër s’është një fletë për kujtesën
As zë që tretet larg nëpër stuhi
Ai është dritë që sfidon harresën
Dhe rreh si zemër në çdo cep n’Shqipëri
Na kthen në agimet e rinisë sonë
Kur ëndrrat çelnin si lule në pranverë
Kur besonim te nderi dhe te dija jonë
Dhe mbi gjithçka e donim Atdhënë
Në çdo faqe dëgjohet zëri i shokëve
Jehonë hapash n’oborrin e vjetër plot jetë
Buzëqeshje, betime e këngë rinore
Që koha s’arriti kurrë, t’i tretë
Na priti shkolla si nënë bujare
Me portat hapur e zemrën plot shkëlqim
Na mësoi ta duam tokën shqiptare
Me besë, me nder e me përkushtim
Në auditorë mbillej dija jonë
N’shtërvitje forcohej shpirti ynë i ri
Një flamur na bëri vëllezër përgjithmonë
Një emër na bashkoi: Shqipëri
Nuk farkëtoheshin vetëm ushtarakë
Por burra me karakter e fisnikëri
Që ta donin Atdheun mbi gjithçka
Me zemër të pastër e ndershmëri
Sot, hapim portën e kujtesës sonë
Për ata që sfidonin çdo rrezik
Që brezat të njohin këtë trashëgimi
Që quhet “Skënderbegas”, emër fisnik

VATRA QË FARKËTOI BURRA

Kur çelnin agimet mbi kodrat me vesë
Na zgjonte kambana me zërin e saj
Për ditën e dijes, të besës e punës
Për shërbimin e Atdheut, n’çdo skaj
Me hap t’njëjtë, në rresht e në rend
Mësuam se forca buron nga bashkimi
Se nderi nuk blihet me ar e pushtet
Por lind nga karakteri dhe përkushtimi
Në klasat, ku dija ndriçonte si diell
Çdo libër hapej si flamur i lirisë
Në fushat e stërvitjes, me djersë e sakrificë
Forcohej vullneti për t’i shërbyer Shqipërisë
Komandantë e mësues, si prindër për ne
Na rritën me disiplinë e dituri
Na mësuam se dashuria për atdhe
Mbështeten mbi punë e përgjegjësi
N’atë vatër ndamë bukën e jetës
Gëzimin, mundimin dhe çdo vështirësi
Vëllezër, përherë bashkë, Si mizat e bletës
Nën një flamur, për nënën Shqipëri

Kur një shok lodhej në rrugën e gjatë
Dhjetë duar shtriheshin sërish ta ngrinin
Se fitorja ishte e t’gjitheve, bashkë
Bashkë forcoheshim, kudo të ishim
Atje mësuam se fjala ka peshë
Se besa nuk thyhet, për asnjë fitim
Dhe se ti lartësohesh kudo t’ jesh
Nga vepra, ndershmëria dhe shërbim

Dhe sot, kur kthehemi me mendje t’qetë
Na duket se koha ka mbetur, s’lëviz
Skënderbegasi mbetet përjetë
Shkolla e jetës, e shqiptari

BETIMI DHE SHËRBIMI

Kur pas, portën e shkollës fisnike lamë
Na priste jeta me sprova e nder
Por zemra ruante betimin e parë
T’i shërbenim Atdheut me besë përherë

Në male, brigje, në fusha e qytete
Na thërriste detyra, në çdo agim
Me shpirt shqiptari dhe ndërgjegje
E mbrojtëm flamurin me nder e përkushtim

Të tjerë kërkuan majat e dijes
Në akademi e në rrugë të reja
Kudo që shkuan lanë gjurmë fisnikërie
Me punë t’ndershme e zemër si rrufeja

S’na lidhi veç uniforma a tonat andralla
As gradat që koha mund t’i harrojë
Na bashkonin besa, nderi dhe fjala
Që n’zemrën shqiptare përjetë rrojnë

Kur valëvitej flamuri kuqezi
Rikthehej betimi i rinisë sonë
Të jetonim me dinjitet e drejtësi
Dhe të mos e ulnim kurrë ballin tonë

U shpërndamë në çdo anë të vendit
Si degë lisi mbi tokën amtare
Por rrënjët mbetën në të njëjtën vatër
Që quhet “Skënderbegas”, shkollë shqiptare

Disa, sot prehen në amshim, të qetë
Me emrat e gdhendur në zemrat tona
Ata jetojnë n’kujtesën e brezave, përjetë
Si yje që ndriçojnë netët e vona

Kështu u shkrua historia jonë e rrallë
Jo me zhurmë, por me punë e dinjitet
Një histori që do të mbetet ajo, e gjallë
Sa të jetojë Shqipëria ndër shekuj e jetë

VËLLAZËRIA QË NUK PLAKET

Vitet kaluan si lumenj me rrëmbim
Mbi flokët tanë hodhën argjendin si tis
Por zemra ruajti të njëjtin betim
Dhe mallin e bukur të ditëve të rinisë

Kur, pas shumë motesh, ndonjërin takon
Harrohen vitet që na mbajtën larg
Një buzëqeshje kujtimet e hershme zgjon
Dhe koha ndalet një çast, kujtimet varg

Shtrëngohen duart me të njëjtën ngrohtësi
Sytë reflektojnë miqësinë që s’e harruan
Rikthehen zërat, këngët ëndrrat, për çudi
Që rrugën e jetës sonë e ndriçuan

Në sofrën tonë mbetet përherë një vend
Për shokët, që sot, mes nesh s’janë

Emrat e tyre jetojnë në zemrat tona
Si yje që s’shuhen dhe pse nga qielli ranë

Ne ishim djem, sot jemi gjyshër
Me thinja, tregues se koha na vodhi rininë
Por brenda nesh jeton ende ai djalë
Që, me zemër, ëndërronte Shqipërinë

Skënderbegasi na lidhi përjetë
Me një nyjë që koha s’e këput dot
Sepse miqësia e lindur në sakrificë
Bëhet lis që sfidon çdo mot

Një ditë ne do t’mbetemi kujtim
Si ata që sot i kujtojmë me mall
Por le të mbetet i gjallë ky bashkim
Si dritë që kalon në breza me radhë

Ushtarakëve që shërbyen me nder dhe dinjitet

Në nderim të të gjithë ushtarakëve shqiptarë që e veshën uniformën me dinjitet, e mbajtën me ndershmëri dhe e dorëzuan me nder.

Kjo poemë u kushtohet atyre burrave dhe grave që zgjodhën rrugën e shërbimit ndaj Atdheut, duke e vënë detyrën mbi interesin personal dhe përgjegjësinë mbi komoditetin. U kushtohet të gjithë ushtarakëve shqiptarë, të cilët, në çdo kohë dhe në çdo detyrë, e nderuan uniformën me përkushtim, disiplinë, profesionalizëm dhe ndershmëri.

Uniforma ushtarake nuk është vetëm një veshje. Ajo është simbol i besimit që një komb u jep bijve dhe bijave të tij për të mbrojtur lirinë, sovranitetin dhe dinjitetin e shtetit. Ta veshësh atë është një privilegj; ta mbash me ndershmëri është një mision; ta dorëzosh me nder është kurorëzimi i një jete të tërë në shërbim të vendit. Pas çdo uniforme fshihet një histori njerëzore: vite përgatitjeje, sakrifica familjare, net pa gjumë, stërvitje të lodhshme, vendime të vështira dhe një betim që nuk shuhet me përfundimin e karrierës ushtarake. Edhe kur uniforma hiqet nga supet, vlerat që ajo përfaqëson mbeten të gdhendura në karakterin e atyre që e kanë merituar ta mbajnë. Kjo poemë është një shenjë mirënjohjeje për të gjithë ata që shërbyen me ndërgjegje dhe dinjitet, për ata që e ruajtën të pastër figurën e ushtarakut shqiptar dhe që, me punën e tyre të heshtur, kontribuuan në forcimin e institucioneve të mbrojtjes dhe në sigurinë e vendit. Ai është gjithashtu një ftesë për brezat e rinj që ta shohin uniformën jo si simbol privilegji, por si simbol përgjegjësie, sakrifice dhe dashurie për Atdheun.

Le të mbetet kjo vepër një homazh për të gjithë ata që nuk kërkuan lavdi, por kryen detyrën; që nuk kërkuan duartrokitje, por respekt; që nuk kërkuan privilegje, por e mbajtën betimin ushtarak si udhërrëfyes të jetës së tyre.Me nderimin më të thellë dhe mirënjohjen më të sinqertë, këtë poemë ua kushtoj të gjithë ushtarakëve shqiptarë që e veshën uniformën me krenari, e mbajtën me dinjitet dhe e dorëzuan me nder.

Lavdi shërbimit të ndershëm. Nder ushtarakut shqiptar. Përjetë respekt për ata që i qëndruan

besnikë betimit dhe Atdheut. USHTARAKËVE QË SHËRBYEN ME NDER DHE DINJITET

Atje ku shqiponjat ngiiten përmes kaltërsisë
Në fushat ku gruri piqet e ngjan si ari
Me zjarrin në gjí dolën bijtë e Shqipërisë
Për t’i kushtuar Atdheut jetën, me besë shqiptari

Me ëndrra rinore e me plot dëshira
Me zemrën që rrihte në ritmin e flamurit
U nisën drejt shkollave më të mira
Aty, ku farkëtohej karakteri i burrit

Aty nuk mësohej veç arti i betejës
As veç komanda, rreshtime rregullore
Aty lindte nderi, besa e fjalës
Që janë mbi gjithçka, se janë njerëzore

Uniformën e veshën si gjë të shenjtë
Jo për medalje, grada a lavdi
Por si një amanet të lënë nga të parët
Të jetojë në breza nëna Shqipëri

N’acarin e dimrit, n’vapën që përvëlton
Në kufij, garnizone, në dete e në male
Qëndruan si shkëmbi që stuhitë sfidon
Me shpirtin e fortë dhe zemrën e madhe

N’çdo repart ku i thirri detyra, me dekada
Lanë gjurmë pune, respekt e besim
Se komandant s’të bën vetëm grada
Por zemra, urtësia e drejtësia n’shërbim

S’kërkuan duartrokitje, lavde, medalje ari
As emrin ta shkruanin në gurë graniti
Mjaftoi ndërgjegjja e pastër si qelibari
Që jetën ia falën Atdheut që i rriti
Sot, uniformat heshtin në dollap
Por shpirti ushtarak është ende krenar
Jeton n’kujtesën e çdo shqiptari, prap
Si betim i shenjtë pranë flamurit kombëtar

Pas çdo ushtaraku, një familje qëndron
Një nënë me lutje, një baba që s’fle
Bashkëshortja që priti netëve, deri vonë
Fëmija, që ia mësoi dashurinë për Atdhe

Këta ndanë heshtjen, pritjen, sakrificën
Pa u ankuar, pa kërkuar lavdinë
Se dhe ata ishin ushtarë të padukshëm
Që mbajtën t’fortë shpresën, shtëpinë

Brezat do t’ecin në shtigje t’reja, plot shpresë
Por nderi nuk plaket dhe koha s’e tret
Shembulli i tyre bëhet yll në kujtesë
Që ndriçon udhën e kombit, përjetë

Le të ngrihet kjo poemë si himn mirënjohjeje!
Për çdo ushtarak që shërbeu me përkushtim
Se Atdheu s’mbahet veç me armë
Por me ndërgjegje, besë dhe fljijim

Kur historia t’hapë librin e saj, një ditë
Me faqet që koha, kurrë, s’i zverdh dot
Me shkronja t’arta, një t’vërtetë, do t’skalitë
Ushtaraku n’zemrën e kombit jeton sot

Nga Drenica në pavdekësi, gruaja që e ktheu jetën në një betim për lirinë e kombit shqiptar

Qerime Halil Radisheva (Shote Galica) - Simbol i luftëtares kombëtare për liri dhe shqiptarizëm

Në kuadrin e 99-vjetorit të shuarjes së Shotë Galicës, 20 korrik 1927 – 20 korrik 2026



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Historia e kombit shqiptar është ndërtuar mbi veprën dhe sakrificën e grave dhe burrave që ia kushtuan jetën mbrojtjes së atdheut dhe identitetit kombëtar. Midis këtyre figurave madhore qëndron Qerime Halil Radisheva, e njohur përjetësisht si Shotë Galica, një nga heroinat më të shquara të rezistencës shqiptare në Kosovë gjatë gjysmës së parë të shekullit XX. Emri i saj është bërë sinonim i patriotizmit, guximit, sakrificës dhe qëndresës kombëtare.

Shotë Galica nuk ishte vetëm bashkëluftëtarja e Azem Galicës. Ajo ishte komandante, organizatore, udhëheqëse dhe simbol i rezistencës shqiptare kundër pushtimit serb. Për më shumë se një dekadë luftoi në vijën e parë të frontit, duke marrë pjesë në dhjetëra beteja dhe duke vazhduar drejtimin e çetës edhe pas rënies së bashkëshortit të saj.

Figura e saj sfidoi jo vetëm pushtuesit, por edhe paragjykimet e kohës. Në një shoqëri ku gruaja konsiderohej larg jetës ushtarake, Shotë Galica dëshmoi se atdhedashuria nuk njeh dallime gjinore. Trimëria dhe vendosmëria e saj fituan respektin e bashkëluftëtarëve, të cilët, pasi panë guximin e saj në betejë, i kushtuan këngë trimërie, privilegj që në traditën shqiptare u rezervojë vetëm burrave më të shquar të armës.

Një jetë në shërbim të çështjes kombëtare

Qerime Halil Radisheva lindi në fshatin Radishevë të Drenicës, në rajonin e Mitrovicës, në një familje me tradita të forta atdhetare. Edhe pse burimet historike paraqesin mospërputhje lidhur me datën e lindjes, shumica e studiuesve e vendosin atë më 4 tetor 1895. Ajo u rrit në një mjedis ku mbrojtja e trojeve shqiptare dhe ruajtja e identitetit kombëtar ishin pjesë e jetës së përditshme.

Ishte motra më e vogël e gjashtë vëllezërve dhe që në fëmijëri u edukua me frymën e kuvendeve, të besës dhe të rezistencës që karakterizonte Drenicën. Atdhedashuria nuk ishte për të vetëm një ideal, por mënyrë jetese.

Në moshën 20-vjeçare, në vitin 1915, ajo u martua me Azem Galicën, një prej prijësve më të njohur të lëvizjes kaçake shqiptare. Martesa e tyre nuk ishte thjesht bashkim familjar; ajo u shndërrua në një aleancë të pathyeshme në shërbim të lirisë së Kosovës.


Shumë shpejt, Shotë Galica u bë pjesë aktive e çetës së Azemit, duke marrë pjesë në aksione të armatosura kundër forcave pushtuese. Duke sfiduar rolin tradicional që shoqëria e kohës u rezervonte grave, ajo zgjodhi jetën e armës, të sakrificës dhe të rezistencës, duke u bërë një ndër figurat më të spikatura të emancipimit kombëtar shqiptar.

Fillimisht mori pjesë në qëndresën kundër pushtimit serb dhe më pas në luftimet kundër forcave bullgare dhe austro-hungareze gjatë Luftës së Parë Botërore. Në vitet **1916–1917** u dallua në përlëshjet e zhvilluara në Obri, Bajë dhe zona të tjera të Drenicës, ku tregoi jo vetëm trimëri, por edhe aftësi të spikatura organizative.

Burimet historike dëshmojnë se në disa raste ajo shpëtoi jetën e Azem Galicës, duke e nxjerrë nga rrethimet armike, duke u kujdesur për plagët e tij dhe duke bërë të mundur vazhdimësinë e luftës së çetës shqiptare.

Në vijën e parë të rezistencës shqiptare

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, gjendja politike në Kosovë u përkeqësua ndjeshëm. Politika e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene synonte shpronësimin,



kolonizimin dhe asimilimin e shqiptarëve.

Përballë kësaj politike, Shotë dhe Azem Galica vazhduan rezistencën e armatosur. Ata morën pjesë në Kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Drenicës në vitin 1919, si edhe në mbrojtjen e Zonës së Junikut gjatë viteve 1921–1923.

Këto ngjarje përbëjnë një nga kapitujt më të rëndësishëm të historisë së rezistencës shqiptare në Kosovë. Në historiografinë shqiptare, Shotë Galica vlerësohet jo vetëm si pjesëmarrëse në beteja, por si një nga drejtueset më të rëndësishme të rezistencës, duke fituar respektin e popullsisë shqiptare dhe të bashkëluftëtarëve të saj. Emri i saj mbetet i lidhur pazgjidhshmërisht me luftën për liri dhe mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve.

Qerime Halil Radisheva (Shote Galica), simbol i luftëtares kombëtare për liri dhe shqiptarizëm

Veprimtaria luftarake, drejtimi i rezistencës dhe sakrifica e një heroine

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Kosova mbeti nën administrimin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Politika e re shtetërore synonte kolonizimin e trojeve shqiptare, shpronësimin e popullsisë vendase dhe ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës. Përballë kësaj gjendjeje të rëndë, rezistenca shqiptare mori një organizim të ri përmes lëvizjes kaçake, e cila u bë simbol i mbrojtjes së identitetit kombëtar.



Në krye të kësaj rezistence qëndronte Azem Galica, ndërsa pranë tij, si bashkëluftëtare dhe bashkë organizatore, ishte gjithmonë Shotë Galica. Ajo nuk mbeti në hijen e bashkëshortit, por u shqua si një luftëtare e vendosur, që mori pjesë drejtpërdrejt në planifikimin dhe zhvillimin e aksioneve ushtarake.

Në vitin 1919, Shotë Galica ishte pjesë aktive e Kryengritjes së Rrafshit të Dukagjinit dhe Drenicës, një nga përpjekjet më të mëdha të shqiptarëve për t'i bërë ballë politikës së dhunshme të autoriteteve serbe. Më pas, gjatë viteve 1921–1923, ajo luftoi për mbrojtjen e Zonës Neutrale të Junikut, ndërsa në periudhën 1923–1924 mori pjesë në mbrojtjen e zonës së lirë të Drenicës, të njohur në histori si **“Arbëria e Vogël”**.

Kjo zonë përfaqësonte një territor ku luftëtarët shqiptarë kishin arritur të organizonin një administrim të pavarur nga autoritetet serbe, duke u shndërruar në simbol të rezistencës kombëtare shqiptare.

Pas rënies së Azem Galicës, në krye të rezistencës

Në korrik të vitit 1924, forcat serbe ndërmorën një ofensivë të fuqishme kundër “Arbërisë së Vogël”. Pas luftimeve të ashpra, Azem Galica u plagos rëndë dhe ndërroi jetë nga plagët e marra.

Humbja e prijësit të lëvizjes kaçake përbënte një goditje të madhe për rezistencën shqiptare, por nuk e ndali luftën. Përkundrazi, në atë moment vendimtar doli në pah personaliteti i Shotë Galicës.

Ajo mori drejtimin e çetës së bashku me Mehmet Delinë dhe Faslli Beranin, duke dëshmuar aftësi të rralla drejtuese, vendosmëri dhe kurajë të jashtëzakonshme. Në këtë periudhë ajo u shndërrua në figurën më përfaqësuese

të rezistencës shqiptare në Kosovë.

Në fund të vitit 1924, Shotë Galica iu bashkua luftëtarëve të Bajram Currit dhe mori pjesë në përpjekjet kundër forcave që mbështetën rikthimin e Ahmet Zogut në pushtet. Pas këtyre zhvillimeve ajo u rikthye në Kosovë, ku vazhdoi organizimin e rezistencës kundër kolonizimit dhe politikave të shkombëtarizimit të shqiptarëve.

Mbi 40 beteja dhe një jetë e tërë në luftë

Burimet historike dëshmojnë se gjatë gjithë veprimtarisë së saj, Shotë Galica mori pjesë në më shumë se 40 aksione të rëndësishme luftarake.

Çdo betejë shoqërohej me rreziqe të mëdha, por edhe me sakrifica të jashtëzakonshme personale. Lufta nuk i mori vetëm rininë; ajo i mori edhe një pjesë të madhe të familjes.

Në këto përballje humbën jetën **22 anëtarë të familjes së saj**, një nga çmimet më të rënda që ka paguar ndonjë familje shqiptare në emër të lirisë dhe çështjes kombëtare.

Megjithatë, asnjëherë nuk hoqi dorë nga ideali për të cilin luftonte. Për Shotën, liria e Kosovës ishte më e rëndësishme se çdo interes personal.

Vitet e fundit: plagët, varfëria dhe dinjiteti

Në fund të vitit 1926, e plagosur rëndë dhe me shëndet të përkeqësuar pas viteve të gjata të luftës, Shotë Galica u detyrua të largohej drejt Shqipërisë.

Fillimisht u vendos në Shullaz pranë Milotit dhe më pas në Derven të Fushë-Krujës.

Megjithëse jetonte në kushte tepër të vështira ekonomike, ajo nuk reshti së ndihmuari të tjerët. Mori nën kujdes fëmijët jetimë të bashkëluftëtarëve të rënë, duke dëshmuar se misioni i saj nuk përfundonte në fushën e betejës, por vazhdonte edhe në mbrojtjen e familjeve të atyre që kishin sakrifikuar për lirinë.

Kjo periudhë dëshmon madhështinë njerëzore të Shotë Galicës, e cila edhe në varfëri mbeti simbol i dinjitetit dhe solidaritetit shqiptar.

Letra prekëse drejtuar Mbretit Zog

Pak para vdekjes, e rraskapitur nga plagët, varfëria dhe sëmundjet, Shotë Galica i drejtoi një letër Mbretit Zog.

Në këtë dokument të rrallë historik ajo përshkruante gjendjen e saj dramatike dhe kërkonte ndihmë jo vetëm për veten, por edhe për katër jetimët e luftëtarëve që kishte marrë nën kujdes.

Në letër ajo shkruante:

“...Jam Shotë Galica, gruaja e Azem Galicës, prijësit të Lëvizjes Kaçake të Kosovës. Kam edhe katër fëmijë jetimë me vete... Jam e shtrënguar t’ju vë në dijeni se jam duke vdekur urie bashkë me fëmijët jetim...”.

Kjo letër mbetet një nga dokumentet më prekëse të historisë shqiptare.

Megjithatë, sipas burimeve historike, ndihma e kërkuar nuk mbërriti kurrë.

Shotë Galica ndërroi jetë më **20 korrik 1927**, në moshën vetëm 32-vjeçare, e rraskapitur nga plagët e luftës, mungesa e kujdesit shëndetësor, varfëria dhe vuajtjet e shumta që e kishin shoqëruar gjatë gjithë jetës së saj.

Edhe pse pati lindur një djalë në vitin 1916, fëmija jetoi vetëm pak javë, duke e shtuar edhe më shumë dhimbjen personale të heroinës shqiptare.

Shote Galica - Simbol i luftëtares kombëtare për liri dhe shqiptarizëm

Trashëgimia historike e një heroine që u kthye në simbol të kombit shqiptar

Sakrifica e Shotë Galicës nuk përfundoi me shuarjen e saj fizike, më 20 korrik 1927. Përkundrazi, jeta dhe vepra e saj u shndërruan në një nga shtyllat më të rëndësishme të kujtesës historike shqiptare. Ajo mbetet një nga figurat më përfaqësuese të rezistencës kombëtare, një grua që i kushtoi çdo ditë të jetës së saj mbrojtjes së popullit shqiptar dhe lirisë së Kosovës.

Për më shumë se dymbëdhjetë vjet, Shotë Galica mori pjesë në mbi dyzet aksione të rëndësishme luftarake. Ajo përballoi plagë të shumta, humbi 22 anëtarë të familjes dhe jetoi mes vuajtjeve, pa u larguar asnjëherë nga ideali për të

cilin kishte marrë armët. Pikërisht kjo qëndrueshmëri e bëri atë një figurë unike në historinë shqiptare.

Nga kujtesa popullore në historiografinë shqiptare

Pas vdekjes, emri i Shotë Galicës nuk u harrua

Fillimisht ajo jetoi në këngët popullore, në rrëfimet e luftëtarëve dhe në kujtesën e brezave që e kishin njohur ose kishin dëgjuar për trimërinë e saj. Më pas, figura e saj u bë objekt studimesh historike, monografish dhe botimesh shkencore.

Emri i saj iu dha shkollave, rrugëve, institucioneve dhe monumenteve në Shqipëri e Kosovë, duke e kthyer në një simbol të përhershëm të rezistencës shqiptare.

Në vitin **1962**, në Fushë-Krujë u ngrit lapidari kushtuar Shotë Galicës, mbi vendin ku prehen eshtrat e saj.

Më **20 tetor 1967**, me Vendimin nr.143 të Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, ajo u dekorua me titullin e lartë **“Heroinë e Popullit”**, si vlerësim për kontributin e jashtëzakonshëm në luftën për liri.

Më **25 nëntor 1978**, me Vendimin nr.154, Shotë Galica u shpall edhe **“Dëshmore e Atdheut”**, duke zënë vendin që meritonte në panteonin e figurave më të mëdha të kombit shqiptar.

Heroina që bashkoi Shqipërinë dhe Kosovën

Figura e Shotë Galicës ka kapërcyer kufijtë e historisë së Kosovës.

Ajo është bërë simbol i përbashkët i gjithë shqiptarëve, këtij dhe matanë kufirit shtetëror, duke përfaqësuar idealin e lirisë, të bashkimit kombëtar dhe të sakrificës.

Busti i saj, i realizuar nga skulptori Kristaq Rama, u vendos në qytetin e Kukësit, si një kujtesë e përhershme për udhëtarët që kalojnë mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Në historiografinë moderne shqiptare dhe ndërkombëtare, studiues si Ajet Haxhia, Marenglen Verli, Robert Elsie, Mehmet Bislimi dhe autorë të tjerë e kanë vlerësuar Shotë Galicën si një nga personalitetet më të rëndësishme të rezistencës shqiptare të shekullit XX.

Në shumë studime ajo krahasohet me heroinat më të njohura të historisë botërore për shkak të vendosmërisë, trimërisë dhe aftësive të saj drejtuese në luftë.

Gruaja që sfidoi kohën

Përtej dimensionit ushtarak, Shotë Galica mbetet edhe një figurë me rëndësi të jashtëzakonshme shoqërore.

Në një epokë kur gratë rrallëherë merrnin pjesë në drejtimin e çetave luftarake, ajo u bë komandante dhe udhëheqëse.

Ajo dëshmoi se mbrojtja e atdheut nuk ishte privilegj i burrave, por detyrë e çdo shqiptari.

Prandaj sot Shotë Galica konsiderohet jo vetëm heroinë kombëtare, por edhe simbol i emancipimit, i barazisë dhe i fuqisë së gruas shqiptare.

Në Kosovë dhe Shqipëri, çdo përvjetor i jetës dhe veprës së saj shoqërohet me aktivitete përkujtimore, konferenca shkencore dhe homazhe, ndërsa emri i saj vazhdon të frymëzojë brezat e rinj me idealet e lirisë, dinjitetit dhe përgjegjësisë ndaj atdheut.

Një trashëgimi që jeton

Historia e Shotë Galicës nuk mbaron me vitin 1927.

Në vitin 2017, Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, themeloi Urdhrin “Shotë Galica”, një dekoratë që u jepet grave dhe burrave që kanë dëshmuar guxim, trimëri dhe kontribut për barazinë gjinore dhe mbrojtjen e vlerave kombëtare.

Figura e saj vazhdon të jetë pjesë e librave, studimeve, dokumentarëve, filmave, dramave, këngëve popullore dhe botimeve historike, duke dëshmuar se ndikimi i saj nuk është zbehur me kalimin e kohës.

Edhe sot këndohet kënga që e përjetëson heroinën: **“Me kangë në gojë, me allti në shokë, u rrit çika me emrin Shotë. Luftoi rreptë me austriakë, hem me pushkë, hem me shpatë...”**

Kënga nuk është vetëm një kujtim folklorik; ajo është dëshmi e vendit që Shotë Galica zë në ndërgjegjen kombëtare shqiptare.

Qerime Halil Radisheva - Shotë Galica, mbetet një nga figurat më të ndritura të historisë sonë kombëtare. Jeta e saj ishte një histori e jashtëzakonshme sakrifice, heroizmi dhe besnikërie ndaj idealit të lirisë. Ajo luftoi në vijën e parë të betejës, udhëhoqi rezistencën pas rënies së Azem Galicës, humbi familjarë, përballoi plagë e varfëri, por nuk e tradhtoi kurrë betimin për mbrojtjen e Kosovës dhe të shqiptarëve.

Sot, pothuajse një shekull pas ndarjes së saj nga jeta, Shotë Galica mbetet simbol i gruas shqiptare që sfidoi kohën, paragjykimet dhe pushtuesit. Emri i saj vazhdon të jetojë në histori, në kujtesën popullore dhe në ndërgjegjen kombëtare si një model i përjetshëm i guximit, dinjitetit dhe dashurisë për atdheun.

Një kërcënim i padukshëm nga Dielli

Dielli është burimi i jetës në Tokë, por edhe një rrezik i madh. Shpërthimet e tij të fuqishme, të njohura si *koronal mass ejections* (CME), dërgojnë drejt planetit tonë re gjigante grimcash të ngarkuara. Kur këto godasin atmosferën, ato mund të shkaktojnë jo vetëm aurora spektakolare, por edhe dëme katastrofike: shkatërrim satelitësh, ndërprerje të rrjetit elektrik, kolaps të internetit dhe rrezik për astronautët. Ngjarja e famshme *Carrington Event* e vitit 1859 është një kujtesë e frikshme se çfarë mund të ndodhë. Sot, një stuhi e tillë do të sillte humbje prej trilion dollarësh dhe paralizim të infrastrukturës globale.

Një ide që tingëllon si fantashkencë

Përballë këtij rreziku, shkencëtarët po shqyrtojnë një ide të guximshme: përdorimin e satelitëve si mburojë për Tokën. Projekti, i quajtur *StormWall*, parashikon një konstelacion prej gjashtë satelitësh në orbitë gjeosinkrone, rreth 36 mijë kilometra mbi Tokë. Kur zbulohet një superstuhi diellore, satelitët do të lëshojnë gaz të veçantë – si barium ose litium – që jonizohet nga rrezet e diellit. Ky proces formon një mur plazme që vepron si “airbag” kozmik, duke devijuar një pjesë të energjisë së stuhisë. Simulimet tregojnë se një mburojë e tillë mund të reduktojë intensitetin e superstuhive me 50% ose më shumë.

Pse është e domosdoshme?

Aktualisht, Dielli ndodhet në fazën më aktive të ciklit të tij 11-vjeçar, duke prodhuar më shumë stuhi. Teknologjia moderne – satelitët, GPS-i, rrjetet elektrike dhe interneti – është jashtëzakonisht e pambrojtur. Një superstuhi e madhe mund të paralizojë botën për javë, ndoshta muaj. Kostoja e mosveprimit është e paimagjinueshme: humbje ekonomike globale, kolaps i komunikimeve dhe pasoja sociale të rënda. Në këtë kontekst, një projekt si *StormWall* shihet jo si luks, por si domosdoshmëri strategjike.

Sfida të mëdha përpara

Megjithatë, ideja nuk është pa sfida. Kostoja e lëshimit të satelitëve dhe materialeve është e lartë, ndërsa përdorimi i tyre është praktikisht “një herë e mbaroi”. Koordinimi ndërkombëtar është i domosdoshëm, pasi një mburojë e tillë nuk mund të ndërtohet nga një vend i vetëm. Ka edhe rreziqe teknike: lëshimi i kimikateve në hapësirë duhet të kontrollohet me kujdes për të shmangur efekte të padëshiruara. Dilema është e qartë: a ia vlen të investohet miliarda për një sistem që mund të përdoret rrallë, por që në rast nevojë mund të shpëtojë civilizimin modern?

Një projekt global

Shkencëtarët besojnë se *StormWall* është teknikisht i realizueshëm dhe mund të jetë mbrojtja e vetme direkte kundër superstuhive. Projekti shihet si një investim global, krahas përmirësimit të parashikimeve të motit hapësinor dhe forcimit të infrastrukturës tokësore. Nëse testet tregojnë sukses, sistemi mund të zbatohet në shkallë më të gjerë në Evropë dhe më tej. Në fund, ideja e përdorimit të satelitëve si mburojë ndaj Diellit nuk është më fantashkencë, por një strategji e diskutuar seriozisht për të mbrojtur Tokën nga një kërcënim kozmik real.

Një dilemë mes kostos dhe domosdoshmërisë

Debati rreth *StormWall* është i ndezur. Nga njëra anë, kostoja e projektit është e jashtëzakonshme dhe kërkon bashkëpunim ndërkombëtar. Nga ana tjetër, rreziku i superstuhive është aq i madh saqë mosveprimi mund të ketë pasoja të paimagjinueshme. Nëse një stuhi e ngjashme me *Carrington Event* do të godiste sot, bota do të përballej me një krizë të paprecedentë. Në këtë kuptim, investimi në një mburojë kozmike shihet si një sigurim për të ardhmen e njerëzimit.



Satelitët si Mburojë ndaj Superstuhive Diellore: Nga Fantashkenca në Strategji Globale

Projekti, i quajtur StormWall, parashikon një konstelacion prej gjashtë satelitësh në orbitë gjeosinkrone, rreth 36 mijë kilometra mbi Tokë. Kur zbulohet një superstuhi diellore, satelitët do të lëshojnë gaz të veçantë – si barium ose litium – që jonizohet nga rrezet e diellit. Ky proces formon një mur plazme që vepron si “airbag” kozmik, duke devijuar një pjesë të energjisë së stuhisë. Simulimet tregojnë se një mburojë e tillë mund të reduktojë intensitetin e superstuhive me 50% ose më shumë.

Përtej StormWall – vizioni i së ardhmes

Disa shkencëtarë sugjerojnë se ky projekt mund të jetë vetëm hapi i parë. Në të ardhmen, mund të ndërtohen struktura më të mëdha mbrojtëse, ndoshta edhe “paravane magnetike” që imitojnë fushën magnetike të Tokës. Të tjerë propozojnë përdorimin e stacioneve hapësinore për të monitoruar dhe neutralizuar stuhitë diellore në fazat e

hershme. Nëse *StormWall* rezulton i suksesshëm, ai mund të hapë rrugën për një epokë të re të mbrojtjes planetare.

Ky projekt është një shembull i qartë se si njerëzimi po kalon nga fantashkenca në zgjidhje reale për të mbrojtur ekzistencën e tij. Në fund, pyetja nuk është nëse duhet të ndërtojmë një mburojë ndaj superstuhive, por kur do ta bëjmë.

Zhvillimi teknologjik dhe dilema e inteligjencës artificiale gjenerative

Në dekadat e fundit, teknologjia ka kaluar nga një mjet ndihmës në një forcë që po riformëson vetë mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë dhe mendojnë. Inteligjenca artificiale gjenerative është shembulli më i qartë i këtij transformimi. Ajo ka aftësinë të prodhojë tekste, imazhe, muzikë dhe ide të reja me një shpejtësi marramendëse, duke e bërë të duket sikur kreativiteti njerëzor është i pafund. Por, ndërsa fuqia e saj është e padiskutueshme, po ngrihet një pyetje e madhe: a po e bën kjo teknologji njeriun më pak mendues, më pak kreativ dhe më të varur nga makina?

Nga revolucioni industrial tek revolucioni digjital

Historia e zhvillimit teknologjik është një histori e përparimit, por edhe e frikës. Në shekullin XIX, makinat e fabrikave u panë si kërcënim për punëtorët, sepse zëvendësonin aftësitë e tyre manuale. Shumë njerëz mendonin se industrializimi do të shkatërronte punën njerëzore, por në fakt ai solli një transformim të madh: punëtorët u zhvendosën nga puna manuale drejt profesioneve të reja, ndërsa prodhimi u rrit në mënyrë të paprecedentë. Sot, algoritmet e inteligjencës artificiale ngjallin të njëjtën dilemë: a do të zëvendësojnë ato mendjen njerëzore?

Në industrinë e medias, AI-ja gjeneron artikuj dhe analiza; në art, krijon piktura dhe kompozime muzikore; në shkencë, ndihmon në zbulime të reja. Por në të gjitha këto fusha, ekziston rreziku që njeriu të humbasë rolin e tij si krijues aktiv, duke u kthyer në një konsumues pasiv të përmbajtjes. Ashtu si makinat e revolucionit industrial ndryshuan mënyrën e prodhimit, AI-ja gjeneruese po ndryshon mënyrën e mendimit dhe krijimit.

Frika e mpirjes mendore

Shumë ekspertë paralajmërojnë se përdorimi i tepruar i AI-së gjenerative mund të çojë në një mpirje mendore të shoqërisë. Kur njerëzit nuk verifikojnë më informacionin, por e marrin të gatshëm nga makina, ata humbasin aftësinë për të menduar në mënyrë kritike. Kur ide të reja nuk lindin nga përvoja njerëzore, por nga algoritme të trajnuara mbi të dhënat e së shkuarës, rrezikohet humbja e kreativitetit original.

Ky fenomen nuk është i panjohur: edhe rrjetet sociale kanë krijuar një kulturë ku konsumimi i përmbajtjes është më i madh se prodhimi i saj. Por me AI-në gjeneruese, rreziku është edhe më i madh, sepse ajo mund të zëvendësojë procesin e mendimit. Nëse çdo vendim, nga më i thjeshti tek më i rëndësishmi, delegohet tek algoritmet, individit mund të ndjehet i paafët pa ndihmën e tyre. Kjo varësi teknologjike mund të prodhojë një shoqëri ku njerëzit nuk janë më prodhues të ideve, por thjesht konsumues të tyre.

Dimensioni filozofik dhe etik

Debati mbi AI-në gjenerative nuk është vetëm teknik, por edhe filozofik. Çfarë do të thotë të jesh njeri në një botë ku makinat mendojnë? A është inteligjenca artificiale një pasqyrë e mendjes sonë, apo një zëvendësues i saj? A po e humbim aftësinë për të reflektuar, për të dyshuar dhe për të krijuar kuptime të reja?

Filozofia e teknologjisë na mëson se çdo mjet i ri nuk është neutral: ai ndryshon mënyrën se si njerëzit e perceptojnë botën. Ashtu si energjia bërthamore kërkoi rregulla të qarta për përdorimin e saj, edhe AI-ja gjeneruese kërkon kufij etikë. Pyetjet mbi pronësinë e ideve, mbi të drejtën e autorit, mbi manipulimin e informacionit dhe mbi ndikimin në demokraci janë thelbësore. Nëse AI-ja mund të gjenerojë tekste bindëse, kush garanton që ato nuk do të përdoren për propagandë apo manipulim masiv?

Balanca e nevojshme

Për të shmangur rrezikun e mpirjes mendore, shoqëria duhet të ndër marrë hapa konkretë. Edukimi duhet të përshtatet, duke mësuar jo vetëm përdorimin e AI-së, por edhe aftësinë për ta sfiduar atë. Nxënësit dhe studentët duhet të mësojnë të dallojnë mes përmbajtjes së gjeneruar dhe asaj të krijuar nga mendja njerëzore, duke zhvilluar aftësi kritike dhe kreative.

Politikat publike duhet të vendosin rregulla për transparencën dhe etikën e algoritmeve, në mënyrë që njerëzit

të mos mbeten të pambrojtur përballë manipulimeve digjitale. Ndërkohë, kultura e mendimit kritik duhet të ruhet dhe të forcohet, sepse vetëm individët që pyesin, dyshojnë dhe krijojnë vetë mund të mbeten të lirë në një botë të dominuar nga teknologjia.

Zgjedhja është në duart tona

Inteligjenca artificiale gjenerative është një nga arritjet më të mëdha të zhvillimit teknologjik të shekullit XXI. Ajo ka fuqinë të prodhojë ide, tekste, imazhe dhe zgjidhje që dikur kërkonin orë, ditë apo edhe vite pune njerëzore. Ky potencial e bën atë një mjet të jashtëzakonshëm emancipues, sepse mund të fuqizojë mendjen njerëzore, ta ndihmojë të kapërcejë kufijtë e njohjes dhe të hapë horizonte të reja për shkencën, artin, kulturën dhe jetën e përditshme. Por, në të njëjtën kohë, ajo mund të shndërrohet në një kurth të rrezikshëm, që e dobëson njeriun, e bën më pak kreativ dhe më të varur nga makina. Prandaj, zgjedhja është në duart tona.

AI-ja si partner emancipues

Nëse e përdorim inteligjencën artificiale gjenerative si partner, ajo mund të na ndihmojë të zgjidhim probleme komplekse që mendja njerëzore e ka të vështirë t'i përballojë vetëm. Për shembull, në mjekësi, AI-ja mund të analizojë miliona të dhëna klinike për të zbuluar modele që ndihmojnë në diagnostikimin e sëmundjeve të rralla. Në shkencë, ajo mund të sugjerojë hipoteza të reja bazuar në të dhëna të

mëparshme, duke përshpejtuar procesin e zbulimit. Në art, mund të shërbejë si një burim frymëzimi, duke i dhënë artistit ide të reja që ai mund t'i zhvillojë më tej me kreativitetin e tij unik.

Në këtë kuptim, AI-ja nuk është zëvendësues i mendjes njerëzore, por katalizator i saj. Ajo mund të shërbejë si një “mikroskop i mendimit”, që na lejon të shohim më thellë, më gjerë dhe më shpejt. Por ky rol emancipues realizohet vetëm nëse njeriu e ruan kontrollin mbi procesin dhe e përdor AI-në si mjet, jo si autoritet absolut.

AI-ja si kurth dobësues

Nga ana tjetër, ekziston rreziku që inteligjenca artificiale gjenerative të shndërrohet në një kurth. Nëse njerëzit fillojnë ta përdorin atë për çdo gjë, pa reflektuar, pa verifikuar dhe pa kontribuar me mendimin e tyre, atëherë mendja njerëzore mund të dobësohet. Kur çdo tekst, ide apo vendim prodhohet nga algoritmet, individit humbet aftësinë për të menduar në mënyrë kritike. Kjo varësi mund të krijojë një shoqëri ku njerëzit ndihen të paafët pa ndihmën e AI-së, duke e deleguar kreativitetin dhe gjykimin tek makina.

Ky skenar është i rrezikshëm, sepse mund të çojë në një “mpirje mendore” kolektive. Në vend që të jemi krijues të kulturës, shkencës dhe artit, mund të shndërrohemi në konsumues pasivë të përmbajtjes së gjeneruar. Dhe kur mendimi kritik humbet, demokracia, liria dhe vetë identiteti njerëzor vihet në rrezik.





BËHU OFICERI I SË ARDHMES!

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë hapin dyert për brezin e ri të liderëve ushtarakë. Je i diplomuar dhe kërkon një karrierë me dinjitet, përgjegjësi dhe perspektivë?

Ky është momenti yt!

Qendra e Personel Rekrutimit fton të rinjtë dhe të rejat të aplikojnë për të ndjekur **Programin e Përgatitjes së Oficerit të Ri** në **Akademinë e Forcave të Armatosura**, për vitin akademik **2026-2027**.

Janë në dispozicion **40 vende studimi**, për kandidatë të diplomuar në fusha të ndryshme universitare, të cilët dëshirojnë të ndërtojnë një karrierë profesionale në shërbim të vendit dhe të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Specialitetet dhe kuotat

Ndërlidhje – 3 kuota

- Diplomë në **Teknologji Informatike (IT)**

Logjistikë – 8 kuota

- Fakulteti Ekonomik
- Financë
- Menaxhim

Inxhinieri – 8 kuota

- Gjeodezi
- Inxhinieri Mekanike
- Transport

Xhenio / Infrastrukturë – 2 kuota

- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Mjekësi – 2 kuota

- Mjekësi e Përgjithshme

Navigim Detar – 3 kuota

Kimi – 2 kuota

Artileri Tokësore – 2 kuota

- Matematikë
- Fizikë

Këmbësori, Polici Ushtarakë, Zbulim, Ligjshmëri dhe Personel – 10 kuota

- Diplomë Bachelor në fusha të tjera

Pse të zgjedhësh një karrierë ushtarakë?

- ✓ Formim profesional në standardet e NATO-s
- ✓ Karrierë e qëndrueshme dhe zhvillim profesional
- ✓ Mundësi specializimi dhe trajnimi brenda dhe jashtë vendit
- ✓ Shërbim në misione dhe stërvitje ndërkombëtare
- ✓ Dinjitet, përgjegjësi dhe lidhshmëri në shërbim të Republikës së Shqipërisë

Mos e humb këtë mundësi!

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 31 gusht 2026.

Zgjidh një profesion me mision.

Zgjidh të udhëheqësh.

Zgjidh të shërbesh.

**Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
Karrierë. Integritet. Shërbim ndaj Atdheut.**